




DVV International

Education for Everyone. Worldwide.
Lifelong.

Kurrikula globALE

Botimi i dytë



DiE

German Institute for
Adult Education
Leibniz Centre for
Lifelong Learning

Botuar nga:

Institut für Internationale Zusammenarbeit
des Deutschen Volkshochschul-Verbandes e. V. (DVV International)
Obere Wilhelmstraße 32, 53225 Bonn
Republika Federative e Gjermanisë

Tel.: +49 (0) 228-97569-0, Fax: +49 (0) 228-97569-55
info@dvv-international.de, www.dvv-international.de

Deutsches Institut für Erwachsenenbildung
Leibniz-Zentrum für Lebenslanges Lernen e. V. (DIE)
Heinemannstraße 12-14, 53175 Bonn
Republika Federative e Gjermanisë

Tel.: +49 (0) 228-3294-0, Fax: +49 (0) 228-3294-399
info@die-bonn.de, www.die-bonn.de

Informata bibliografike botuar nga Die Deutsche Bibliothek.
The Deutsche Nationalbibliothek e liston këtë botim në
Deutsche Nationalbibliografie; të dhënat e hollësishme bibliografike
gjenden në <http://dnb.ddb.de>

ISBN

© 2015 DVV International, DIE

Autorët (Botimi i 2^{is}):
Maja Avramovska, Tania Czerwinski, Susanne Lattke

Layout:
Visar Domi

Print:
Shtypshkronja Orient-Prishtinë

Parathënie	4
A Hyrje në Kurrikulën globALE	5
1. Portret i shkurtë i Kurrikulës globALE.....	5
2. Si është zhvilluar Kurrikula globALE? – burimet dhe metodat e Methods applied	7
3. Some considerations on the global character of Curriculum globALE	9
4. Curriculum globALE and the Human Rights-Based Approach	11
5. Principles of Curriculum globALE.....	12
6. Overview of the Curriculum globALE	14
7. Some guidance on implementing the Curriculum globALE.....	17
8. Quality assurance and monitoring	21
Acknowledgments.....	23
Literature	24
B Module Descriptions	25
Module 0: Introduction.....	25
Module 1: Approaching Adult Education.....	27
Module 2: Adult learning and adult teaching	30
Module 3: Communication and group dynamics in Adult Education.....	33
Module 4: Methods of Adult Education.....	36
Module 5: Planning, organisation and evaluation in Adult Education	39
Electives Module(s): Varying topic(s).....	42
About DIE and DVV International	43

Ky publikim prezenton Kurrikulën globALE që përcakton një kuadër bazë të kualifikimit për edukatorët e të rriturve në mbarë botën. Duke siguruar një pikë referimi që përfshin të gjitha kontinentet, Kurrikula globALE është unike në synimin e saj për ta çuar përpara profesionalizmin e arsimit për të rritur në një shkallë ndërkombëtare.

Të mësuarit dhe arsimimi i të rriturve përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të mësimin tërëjetësor që sot njihet gjerësisht për nga roli kyç në adresimin e sfidave me të cilat individët dhe shoqëritë po përballen globalisht. Siç pohon Korniza për Veprim Belém, e miratuar në Konferencën e 6-të Ndërkombëtare për Arsimin e të Rriturve të UNESCO-s (CONFINTEA VI) në dhjetor 2009: “Nxënia dhe arsimit i të rriturve pajisin njerëzit me njohuritë e nevojshme, aftësitë, zotësitë, kompetencat dhe vlerat për të ushtruar dhe avancuar të drejtat e tyre dhe për të marrë kontrollin mbi fatin e vet. Nxënia dhe arsimit i të rriturve janë gjithashtu imperativ për arritjen e barazisë dhe të përfshirjes, për zbutjen e varfërisë dhe për ndërtime të shoqërive të barabarta, tolerante, të qëndrueshme dhe të bazuara në dije” (UNESCO 2009).

Por, nëse nxënia e të rriturve synon të arrijë potencialin e plotë, ajo duhet të përkrahet nga njerëzit që kanë kompetencat e duhura profesionale. Ndërsa mësuesit e fëmijëve të vegjël në shkollë zakonisht kanë kryer ndonjë program të arsimit profesional, shpesh në nivel universitar, para se të japin mësim, kjo shpesh nuk ndodh me personat që i mësojnë të rriturit. Profesionalizimi i arsimit për të rritur pra, perceptohet si sfida kyçe në mbarë botën, si në nivel vendi individual ashtu edhe në kontekstin ndërkombëtar. Korniza për Veprim Belém identifikon profesionalizmin e arsimit për të rritur si një nga sfidat kryesore për fushën dhe vëren: “Mungesa e profesionalizimit dhe e mundësive të trajnimit për arsimuesit ka pasur një ndikim negativ në cilësinë e nxënies së të rriturve dhe ofrimin e arsimit (...)” (UNESCO 2009). Rreth një e treta e 150 raporteve të vendeve për arsimimin e të rriturve, të paraqitura për konferencën e cituar, nënvizonin kualifikimin e pamjaftueshëm të personelit si një nga fushat më të mëdha në të cilat duhen ndërmarrë veprime (UIL 2009).

Si reagim ndaj kësaj gjendjeje, ndër të tjera, shtetet anëtare të UNESCO-s në konferencën CONFINTEA u angazhuan për “trajtime, aftësimin e kuadrove, kushtet e punësimit dhe profesionalizimin e arsimuesve të të rriturve, p.sh. nëpërmjet krijimit të partneritetit me institucionet e arsimit të lartë, shoqatat e mësuesve dhe organizatat e shoqërisë civile” (po aty).

UNESCO nuk është i vetmi lojtar që thekson rëndësinë e zhvillimit profesional të mësimeve të arsimit të të rriturve. Në nivelin e Bashkimit Evropian, tema e profesionalizimit të arsimit të të rriturve ka përfunduar rritje të vëmendjes së politikave tash sa vjet që kur u apostrofua në komunikimin e parë të Komisionit Evropian për nxënien tek të rriturit (Komisioni Evropian 2006), në planin e veprimit për arsimimin e të rriturve, që doli pas një viti (Komisioni Evropian 2007 dhe në rezolutën e Këshillit 2011 mbi agjendën e ripërtëritjeve evropiane për të mësuarit tek të rriturit (Këshilli 2011). Projekte të shumta, projekte kombëtare e ndërkufitare bashkëpunimi, u iniciuan që atëherë për të identifikuar kërkesat e kompetencave, për të përcaktuar standardet dhe zhvilluar ofrimin e trajnimit për mësuesit dhe trajnuesit e arsimit të të rriturve dhe të Arsimit dhe Formimit Profesional (shih për shembull CEDEFOP 2013).

Këto zhvillime përbëjnë sfondin e përgjithshëm për iniciativën e ndërmarrë bashkërisht nga Instituti Gjerman për Arsimin e të Rriturve - Qendra në Leibniz për të mësuarit tërëjetësor (DIE) dhe Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës së Qendrave Gjermane të Arsimit të të Rriturve (DVV International) për të zhvilluar, testuar dhe shpërndarë një program bazë për trajnimin e arsimuesve të të rriturve jashtë sektorit universitar që, duke qenë në përputhje me parimet themelore të arsimit për të rritur, i plotëson standardet ndërkombëtare shkencore dhe është i përshtatshëm për përdorim në një shkallë transnacionale. Kurrikula globALE është rezultati i kësaj nisme. Qëllimi kryesor, për të cilin Kurrikula globALE mendohet të kontribuojë, është i trefishtë:

- rritja e profesionalizimit të arsimuesve të të rriturve duke ofruar një kuadër të përbashkët referencial
- përkrahja e ofruesve të arsimit të të rriturve për hartimin dhe zbatimin e programeve Trajnim-për-Trajnerë, dhe
- nxitja e shkëmbimit të njohurive dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë mes arsimuesve të të rriturve në mbarë botën.

Pjesa A e këtij publikimi ofron një hyrje të detajuar në Kurrikulën globALE. Ajo fillon duke përshkruar karakteristikat e saj kryesore me një portret të shkurtë (A1). Pastaj paraqiten burimet më të rëndësishme mbi të cilat është ndërtuar kurrikula dhe përcakton procedurën metodologjike për zhvillimin e kurrikulës (A2). Seksionet A3 - A5 i kushtohen shpjegimit të disa parimeve të përgjithshme dhe konsideratave themelore të Kurrikulës globALE. Përbërja dhe struktura e kurrikulës shpjegohen hollësisht në seksionin A6. Kjo pasohet nga një kapitull më i madh (A7), që merret me aspekte të ndryshme lidhur me zbatimin praktik të programit mësimor. Pjesa A përfundon me një përmbledhje të përgjithshme të monitorimit dhe të kornizës së sigurimit të cilësisë të ngritur për Kurrikulën globALE (A 8).

Përshkrimet e plota të moduleve të Kurrikulës globALE mund të gjenden në Pjesën B.

1. Portret i shkurtë i Kurrikulës globALE

Kurrikula globALE (KG) është një kuadër kurrikular modular i bazuar në kompetenca për trajnimin e arsimuesve të të rriturve në mbarë botën. Niveli i kualifikimit është një kualifikim bazë për fushën e arsimit për të rritur. Një arsimues për të rritur që punon kryesisht në mësimdhënie është marrë si profil profesional referencial. Me fjalë të tjera, rezultatet e të nxënësve të përshkruara në programin mësimor përbëjnë një kualifikim që instruktorët e kursit, trajnerët, ligjëruesit dhe individët e ngjashëm duhet ta kenë si parakusht për ta kryer punën e tyre në mënyrë profesionale. Në lidhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, niveli i kompetencave të shënjestruar nga kurrikula do të klasifikohet rreth Nivelit KEK 5.¹

Rezultatet e të nxënësve të përshkruara në kurrikulë përbëjnë thelbin standard që është konsistent në të gjitha vendet dhe nuk mund të ndryshohet. Në këtë kuptim, Kurrikula globALE mund të shihet se përfshin një lloj meta-kornize të kompetencave për arsimuesit e të rriturve: rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në programin mësimor përfaqësojnë bash ato kompetenca që të gjithë arsimuesit e të rriturve duhet t'i posedojnë, pa marrë parasysh kontekstin gjeografik, institucional ose të domenit ku ata punojnë.

Zbatimi i Kurrikulës globALE në thelb d.m.th. ngritje e një program trajnimi i cili siguron se kompetencat e përcaktuara në planin mësimor janë kapur nga të trajnuarit. Forma dhe karakteri i saktë i programeve të trajnimit mund të ndryshojnë – madje dukshëm – sipas nevojave lokale. Për ta mbështetur zbatimin, përshkrimet e moduleve japin indikacione shtesë se si mund të arrihen rezultatet e të nxënësve dhe si mund të zhvillohen kompetencat përkatëse. Prandaj, çdo përshkrim moduli (gjenden në pjesën B të këtij botimi) përfshin, përveç përcaktimit të rezultateve të të nxënësve/kompetencave për t'u zhvilluar, informacione mbi **karakteristikat zbatuese** të mëposhtme:

- një përmbledhje temash dhe pyetjesh për vetëreflektim që do të ndihmojnë për t'i arritur rezultatet e identifikuara të nxënësve
- një përzgjedhje literature të përshtatshme për studim për vetënxënien ose përdorim në klasë
- rekomandime mbi zbatimin e metodologjisë didaktike
- rekomandime mbi afatet për modulet individuale²

E gjithë gama e moduleve ofron një themel të fortë për hartimin e një programi të përshtatshëm trajnimi me të cilin arsimuesit e të rriturve mund t'i zhvillojnë kompetencat e nevojshme. Mbasi kushtet kontekstuale dhe nevojat specifike të grupeve të synuara megjithatë do të ndryshojnë dukshëm mes rajoneve, institucioneve të ndryshme ose fushave, elementet e listuara më sipër - temat, literatura e sugjeruar, metodat didaktike të propozuara - kanë më shumë karakter rekomandimi. Ato mund të jenë subjekt i ndryshimeve në një masë më të madhe a më të vogël në bazë të kontekstit të veçantë të aplikimit. Kurrikula ka për qëllim prandaj të sigurojë një model që mund të merret si bazë për hartimin e programeve individuale të trajnimit që mund të ndryshojnë sa u përket lëndëve të veçanta, materialeve, metodave dhe formateve, sipas nevojave në një kontekst të caktuar, por që megjithatë të gjitha korrespondojnë me një standard të përbashkët kompetencash.

Certifikatat KG për module individuale si dhe për të gjithë kurrikulën mund të jepen sapo ky standard kompetence të jetë arritur, d.m.th. sapo të trajnuarit të kenë fituar kompetencat e përcaktuara në kurrikul. Këto kompetenca mund të jenë fituar si nëpërmjet ofrimit të trajnimit KG me mësim ose nëpërmjet të mësuarit paraprak. **Njohja e të mësuarit paraprak** (NjMP) në fakt ofron një mjet tjetër për përshtatjen e përmbajtjeve të trajnimit, të bazuara në KG për nevojat individuale: Pjesëmarrësit që tashmë posedojnë një pjesë të kompetencave të mbuluara nga Kurrikula globALE mundën, p.sh. përmes NjMP, të përjashtohen nga pjesë të caktuara të trajnimit. Përdorimi i NjMP kërkon mjete dhe procedura të përshtatshme që sigurojnë se kompetencat e pjesëmarrësve mund të identifikohen dhe të dokumentohen në mënyrë të drejtë dhe transparente. Ofruesit e trajnimit KG megjithatë mund të mos jetë gjithmonë në gjendje që ta aplikojnë NjMP – për çfarëdo arsyesh.

¹ Niveli KEK 5 përafërsisht korrespondon me një program të shkurtër studimit në nivel universitar nën nivelin Bachelor (që korrespondon me nivelin e KEK 6) (Parlamenti Evropian / Këshilli i Bashkimit Evropian 2008). Për sa i përket Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit të UNESCO-s (ISCED), versioni 2011, niveli i referencës do të ishte edhe 5. Shkaku i kohëzgjatjes më të shkurtër/volumit, një program trajnimi i bazuar në Kurrikulën Globale normalisht nuk do të mjaftonte i vetëm për përfundimin e nivelit ISCED 5. Megjithatë, duke pasur parasysh kriterin e kompleksitetit të përmbajtjes, një program trajnimi KG mund të llogaritet drejt përfundimit të një programi ISCED niveli 5 (UIS 2012).

² Kjo i referohet vetëm në mënyrë shembullore një formati të mundshëm të zbatimit të kurrikulës së përgjithshme, përkatësisht një programi tradicional trajnimi me blloqe kompakte mësimi. Në praktikë, janë të mundshme qasje dhe formate shumë të ndryshme në kombinime të ndryshme për të arritur rezultatet e nxënësve: programet e mentorimit ose puna e projektit për shembull, përveç blloqeve klasike të mësimi. Do të jetë e mundshme një formë e dokumentimit dhe njohjes (së pjesshme) të kompetencave që tashmë janë fituar në mënyrë joformale. Autorët e KG gjithashtu synojnë të hetojnë format specifike që ofrojnë tilla potencialisht mund të kenë.

Për një rast specifik në të cilin ofruesit e trajnimit planifikojnë të lëshojë një certifikatë KG tërësisht në bazë të materialit të mësuar, një grup i **kërkesave minimale** është përcaktuar që duhen respektuar në zbatimin e këtij trajnimi KG. Këto kërkesa minimale ofrojnë sigurimin e nevojshëm të cilësisë në zbatimin e një trajnimi KG; për më tej, ato ofrojnë disa udhëzime shtesë për ofruesit e trajnimeve të cilët dëshirojnë ta hartojnë vetë trajnimin e tyre KG. Kërkesat minimale përcaktojnë një sërë kriteresh që lidhen me përmbajtjen e të mësuarit që do të mbulohej, si dhe me aktivitetet e mundshme të mësimit dhe të vlerësimit që do të aplikohen gjatë një trajnimi të tillë. Kërkesat minimale janë pjesë e materialit mbështetës i cili vazhdimisht zhvillohet për implementimin e KG dhe mund të shkarkohen nga faqja e internetit KG (www.curriculum-globale.de). Faqja e internetit si tërësi do të vazhdojë të zhvillohet hap pas hapi si një pellg burimesh për përdoruesit e KG. Përveç dokumenteve themelore të KG, do të ofrojë **materiale mbështetëse zbatimi** të tilla si manual që ofron udhëzime për zbatimin, kurrikulës trajnimi me shembuj me bazë në KG, materialet për mësimnxënie, lidhjet me burimet, listat e përditësuara të literaturës, etj.

Elementi KG	Funksioni	Karakteri	Ku mund të gjendet
Material përkrasë zbatimi (manualë, shembuj praktikash të mira, material nxënieje/mësimi)	Të ofrohen modele, shembuj dhe mjete praktike për zbatimin e KG	Mund të përdoret lirisht nga ata që zbatojnë KG	
Kërkesat minimale për trajnim të certifikuar KG (lidhur me përmbajtjen e mësimeve dhe aktivitetet e vlerësimit)	Sigurimi i cilësisë; të ofrojë udhëzime për ofruesit e trajnimeve për caktimin e prioritetëve gjatë zhvillimit të programit të trajnimit KG	Të detyrueshme nëse do lëshohet për të trajnuarit certifikatë që mban logon KG (<i>përjashtim</i> : nëse të trajnuarit kanë zënë do pjesë kompetencash prej mësimeve paraprake dhe nëse NjMP mund të zbatohet përkatësisht, atëherë mund të ulen krahas kërkesat minimale)	Uebfaqja e Kurrikulës globALE (www.curriculum-globale.de)
Përshkrim tiparësh zbatuese (temat e mësimeve, kohëzgjatja e formati i trajnimit, sugjerime literature, etj.)	Të ofrojë frymëzim e orientim për ofruesit e trajnimeve për jetësimin e KG	Rekomandim, informacion indikativ; mund të përshtatet nëse duhet	Publikimi Kurrikula globALE (Pjesa B)
Përkufizim kompetencash/ rezultatesh të të nxënit që të diplomuarit e KG duhet t'i kenë përvetësuar	Vendosje standard	I detyrueshëm, nuk mund të ndryshojë	

Pasqyrë: Elementet kyçe dhe mbështetëse të Kurrikulës globALE

Kush do ta përdorë Kurrikulën globALE?

Kurrikula fillimisht synohet për **institucionet dhe organizatat në fushën e arsimimit të të rriturve** që dëshirojnë të sigurohen se niveli i kualifikimit të arsimuesve të tyre plotëson standardet profesionale. Si një kuadër referimi i sigurimit të cilësisë, Kurrikula globALE ofron një standard ndërkombëtar që gjithashtu adreson **audienca specialiste** të interesuara të tjera dhe **vendimmarrësit e politikave të arsimit** përtej nivelit të institucioneve të arsimit të të rriturve.

Sa i përket aplikimit të veçantë, kurrikula dhe ky botim synohen kryesisht për **individë të përfshirë në planifikimin dhe organizimin e programeve të kualifikimit për arsimuesit e të rriturve**.³ Duke përcaktuar rezultatet e të nxënit, kurrikula ofron një kuadër orientues për këtë punë në lidhje me objektivat që duhet të arrihen përmes programeve të kualifikimit. Nëpërmjet treguesve të mëtejshëm dhe materialeve mbështetëse lidhur me temat, përmbajtjen, metodat dhe formatet, kurrikula ofron ndihmë shtesë me planifikim dhe zbatim të veçantë të programeve individuale.

³ "Arsimuesit e të rriturve" formojnë për vetvete grupin e synuar të tërthortë të kurrikulës. Ajo që duhet të kuptohet me termin " arsimues i të rriturve" në raste individuale dhe ajo me çka lidhen pritshmëritë me këtë rol profesional, mund të ndryshojë në masë të madhe në vende dhe rajone të ndryshme të botës (shih më poshtë edhe seksionin A3).

2. Si u zhvillua Kurrikula globALE? – Burimet dhe metodat e zbatuara

Burimet

Kurrikula globALE bazohet në tri shtylla kryesore:

- Programet ekzistuese Trajnim-për-Trajnuesit nga konteksti i punës së projektit të DVV International
- Sistemet dhe standardet ekzistuese të kualifikimit shtetëror për arsimuesit e të rriturve
- Standardet transnacionale të kompetencave për arsimuesit e të rriturve që janë vënë brenda kornizës së projekteve evropiane

a) Programet nga puna e projektit të DVV International

Programet e Trajnimit-të-Trajnerëve që janë zhvilluar posaçërisht për fusha të ndryshme të aplikimit, janë përdorur me vite në kuadër të punës së projektit të realizuar nga DVV International. Disa nga këto materiale kanë një karakter transnacional, rajonal, p.sh. në kontekstin aziatik ose afrikan, të tjerët lidhen me vende individuale, p.sh., territoret palestineze, Afrikën e Jugut ose Uzbekistanin. Të gjitha programet janë zhvilluar me bashkëpunimin mes përfaqësuesve të DVV International dhe aktorëve vendorë, duke sjellë ekspertizë shtesë nga rrjetet ndërkombëtare të DVV International sipas nevojave.

b) Sistemet dhe standardet e kualifikimeve shtetërore

Siç tregohet nga raportet CONFINTEA VI, programet e profesionalizimit për arsimuesit (e ardhshëm) të të rriturve ekzistojnë në shumë vende. Këto ndryshojnë dukshëm sa i përket qëllimit, spektrit të temës, nivelit të kualifikimit dhe shkallës së formalizimit. Ato shkojnë nga një kurs diplomimi në studime të arsimit në një universitet të zgjat disa vite deri te kurset njëditore të arsimit të vazhdueshëm në një gamë të gjerë temash të veçanta.

Shumë prej këtyre programeve janë iniciativa të izoluara të zbatuara në bazë të projektit, p.sh. konceptet e trajnimit që janë zhvilluar për të mbuluar një nevojë të veçantë për një situatë aktuale pa ndonjë ambicie të zhvillimit të programeve afatgjata nga kjo bazë ose përpjekje për të krijuar një lidhje me sistemin formal të arsimit.

Megjithatë, në një varg vendesh ka në ofertë edhe programe të përhershme dhe sisteme kualifikimi. Ofruesit zakonisht janë institucione të arsimit të lartë (në rastin e programeve diplomë) ose organe të rëndësishme të arsimit të të rriturve që ofrojnë arsimim të vazhdueshëm për personelin e tyre, p.sh. kualifikim bazë për instruktorët e kurseve të ofruara nga shoqata gjermane e arsimit të të rriturve. Në vetëm disa vende - p.sh. Austri, Zvicër e Angli - sistemet e kualifikimit jashtë universiteteve janë ngritur te të gjithë ofruesit në nivel kombëtar për arsimuesit e të rriturve. Disa nga këto sisteme përfshijnë certifikimin e kompetencave të fituara në mënyrë joformale si komponentë. Nëpërmjet një procedure të njohjes në të cilën kompetencat ekzistuese konstatohen dhe certifikohen, dhe kombinohen me vijimin shtesë të moduleve të kursit për t'i fituar kompetencat e munguara, arsimuesit e të rriturve janë në gjendje të marrin një kualifikim të njohur në shkallë kombëtare në këto vende.

Sistemet e tilla të vendosura të kualifikimit dhe modelet bashkë me standardet e tyre përkatëse të kompetencave themelore shërbyen si pika të rëndësishme reference për zhvillimin e Kurrikulës.

Janë shqyrtuar veçanërisht shembujt e mëposhtëm:

- **Certifikata SVEB.** Certifikatë e ofruar nga Federata Zvicerane për Arsimitin e të Rriturve (SVEB) është hapi i parë në sistemin zviceran modular “trajnimi i trajnerëve” (Ausbildung der Ausbildenden). Certifikata formon kualifikimin bazë për instruktorët e kursit në arsimimin e të rriturve që është i njohur në të gjithë Zvicrën. Për ta marrë certifikatën, duhet të plotësohet një modul trajnimi i përbërë nga 90 orë kohë mësimi plus 165 orë vetëstudim, si dhe të paktën dy vjet përvojë profesionale me së paku 150 orë mësimdhënieje në arsimin e të rriturve. Një procedurë për vlerësimin e titujve të kompetencave ekzistuese mund të zëvendësojë përfundimin e modulit të trajnimit.⁴

⁴ <http://www.alice.ch/de/ada/zertifikate/> (Qasja e fundit: 08.10.2015)

- **Certifikata WBA “Arsimues i Certifikuar i të Rriturve”:** Certifikata përbën të parin e dy niveleve të kualifikimit për arsimuesit e të rriturve në kuadër të Akademisë Austriake të Edukimit të Vazhdueshëm (WBA). WBA është pjesë e sistemit bashkëpunues austriak të arsimit për të rritur të Institutit Federal Austriak për Arsimin e të Rriturve. WBA përshkruan standardet në formën e një programi. Për të marrë certifikatën, arsimuesit e të rriturve duhet të provojnë se kanë kompetencat e përshkruara dhe kjo mund të marrë formë të ndryshme. Çdo kompetencë që mungon mund të fitohet më tej duke ndjekë kurse. Përvoja relevante praktike e të paktën 300 orëve të punës së arsimit për të rritur është gjithashtu parakusht për ta fituar certifikatën.⁵
- **Diploma për Mësimdhënie në Sektorin e Mësimin Tërëjetësor (DTLLS).** Më 2007, marrja e një kualifikimi përkatës të akredituar parashkruhet me ligj në Angli për mësuesit në sektorin e financuar publikisht të arsimit të vazhdueshëm. Që nga viti 2007, anëtarët e rinj për arsimin e të rriturve duhet ta përfundojnë një kurs themelor prej 30 orësh në vitin e parë të mësimdhënies. Për të marrë kualifikimin e plotë DTLLS, një program i gjerë trajnimi modular, i cili mund të kryhet edhe gjatë shërbimit për 1 deri në 2 vjet, duhet të përfundojë brenda pesë vjetësh. 150 orë mësim në vit është një parakusht dhe përbën element integral të këtij programi trajnimi. Për t'u akredituar, programet DTLLS duhet të jenë në përputhje me “Standardet Profesionale LLUK për Mësuesit, Tutorët dhe Trajnerët në Sektorin e të Mësuarit Tërëjetësor”, që përcakton kornizën e referencës për kompetencat që duhen fituar.⁶

c) Standardet e kompetencave transnacionale nga projektet e BE

Shtylla e tretë që siguroi bazën për Kurrikulën globALE ishte një varg studimesh dhe projektesh evropiane që trajtuan profilet e kompetencave të arsimuesve të të rriturve gjatë viteve të fundit. Një pjesë e këtyre projekteve merreshin me çështjen e përcaktimit, në një mënyrë të orientuar kah hulumtimi, se cilat kompetenca (bazë) duhet t'u kërkohen arsimuesve të të rriturve. Projektet e tjera i dedikoheshin zhvillimit të mjeteve të veçanta të portofolit për arsimuesit e të rriturve me të cilat mund të regjistrohen kompetencat tashmë ekzistuese, mund të identifikohen nevojat për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional mund të planifikohet në mënyrë të synuar. Për shkak të fokusit të tyre transnacional dhe objektivit të përcaktimit të standardeve, këto projekte dhe profilet rezultuese të kompetencave ishin me interes të veçantë për zhvillimin e Kurrikulës globALE.

Janë marrë parasysh studimet dhe modelet e mëposhtme evropiane:

- **Një Arsimues i Mirë i të Rriturve në Evropë (AGADE) (2004-2006):** Projekti, me partnerë nga Estonia, Irlanda, Letonia, Norvegjia, Portugalia, Suedia dhe Hungaria, zhvilloi standardet minimale për arsimuesit e të rriturve në Evropë, si dhe një kurrikul për një kurs trajnimi të ndërtuar mbi këtë bazë. Standardet u referohen katër roleve të ndryshme të një arsimuesi të të rriturve: Mësues, Udhëzues, Lehtësues dhe Trajner. Gjithsej 16 kritere janë zhvilluar dhe grupuar ose si kritere që lidhen me personin individual ose si kritere të tjera që kanë të bëjnë me fushën profesionale.
- **Vlefshmëria e Kompetencave Informale dhe Joformale Psiko-Pedagogjike të Arsimuesve të të Rriturve (VINEPAC) (2006 - 08):** Projekti, me partnerët nga Gjermania, Franca, Malta, Rumania dhe Spanja, zhvilloi një mjet për vlerësimin e kompetencave psiko-pedagogjike të mësuesve (trajnerëve) në arsimin e të rriturve. I quajtur “Valid-pack”, mjeti përbëhet nga një model i diferencuar kompetence me grupimet “njohuri”, “trajnim/ menaxhim”, “vlerësim dhe valorizim i të mësuarit”, “motivim dhe këshillim” dhe “zhvillim personal dhe profesional”.
- **Shtigjet fleksibile të profesionalizimit për arsimuesit e të rriturve ndërmjet nivelit 6 e 7 të KEK (Flexi-Path):** Projekti, me partnerët nga Gjermania, Estonia, Britania e Madhe, Italia, Rumania, Zvicra dhe Spanja, zhvilloi një mjet të portofolit të kompetencës për të kualifikuar arsimues të të rriturve. Instrumenti identifikon kompetencat në tri fusha (Nxënie – Njerëz – Praktikë) që janë të rëndësishme për arsimuesit e të rriturve që marrin përgjegjësinë për planifikimin, menaxhimin dhe udhëheqjen përtej punës së tyre mësimore. Instrumenti është i bazuar në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

⁵ http://www.wba.or.at/studierende/kompetenzen_zertifikat.php (Qasja e fundit: 08.10.2015)

⁶ <http://collections.europarchive.org/tna/20110214161207/http://www.lluk.org/wp-content/uploads/2010/11/new-overarching-standards-for-ttt-in-lifelong-learning-sector.pdf> (Qasja e fundit: 08.10.2015)

Më 2013 DTLLS u zëvendësua nga Diploma në Arsim dhe Trajnim (DET).

- **Kompetencat kryesore të profesionistëve të nxënies së të rriturve (2010):** Studimi në mbarë BE-në i kryer nga instituti Holandez për Hulumtime voor Beleid synonte t'i identifikonte kërkesat kryesore kompetencë për arsimuesit e të rriturve në Evropë dhe për të krijuar një kornizë përkatëse reference të "kompetencave kyçe të profesionistëve të nxënies së të rriturve". Kuadri i referencës mbulon tërë fushën profesionale të arsimit të të rriturve, duke përfshirë të gjitha rolet dhe funksionet e mundshme profesionale. Brenda vetë projektit, nuk u bë dallim lidhur me nënfushat e arsimit të të rriturve ose rolet individuale profesionale. Megjithatë, kuadri referencë ofron një pikënisje për këtë.⁷
- **Të kualifikuar për të dhënë mësim (QF2Teach) (2009 - 2011):** Projekti, me partnerët nga Gjermania, Britania e Madhe, Italia, Holanda, Polonia, Rumania, Suedia dhe Zvicra, kreu një studim Delphi në vendet partnere për çështjen se cilat kompetenca duhet t'i kenë mësuesit në arsimin e vazhdueshëm pavarësisht nga konteksti i punës së tyre të veçantë. Nga rezultatet e anketës, u hartua një katalog që përmbledhonte nëntë kompetencat themelore. Ato janë zhvilluar në mënyrë të detajuar në formën e një kornize të kualifikimeve të bazuar në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.⁸

Procesi i zhvillimit

Zhvillimi i Kurrikulës globALE u krye në disa hapa:

Programet ekzistuese të trajnimit janë analizuar sistematikisht lidhur me temat dhe përmbajtjet e tyre, veçmas sa i përket rezultateve të synuara të të nxënies dhe kompetencave. Qëllimi ishte të filtrohej thelbi i përbashkët që ishte i rëndësishëm në të gjitha shtetet dhe projektet që u mbuluan.

- Mbi këtë bazë, u identifikuan fushat tematike themelore paraprake të kurrikulës së synuar, secila prej të cilave duhet të mbulohej nga një modul i veçantë.
- Zhvillimi i moduleve individuale, bashkë me formulimin e objektivave të të nxënies, kompetencave dhe fushave të përmbajtjes u krye pastaj në një proces me shumë hapa. Hapat e zhvillimit individual janë krahasuar vazhdimisht me modelet e lartpërmendura kombëtare dhe evropiane të referencës. Kështu është siguruar se kurrikula do të ishte në gjendje me qenë e lidhur me standardet ekzistuese ndërkombëtare.
- Përveç këtij krahasimi me modelet ekzistuese, gjatë fazës së zhvillimit, grupi i projektit mori komente për draftet e përkohshme nga kolegë dhe ekspertë individualë. Këto komente pastaj u morën parasysh për zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulës. Gjatë procesit të zhvillimit, fytyra e modulit dhe draftet ndryshuan disa herë.
- Drafti i parë i kurrikulës së plotë u diskutua dhe u validua në një punëtori me ekspertë të arsimit të të rriturve nga shkencat dhe praktika në fund të vitit 2012. Në bazë të diskutimit, drafti aktual më pas u rishikua në punëtorinë e ekspertëve.
- Testet e para në terren me kurrikulën e rishikuar u kryen në disa prej shteteve partnere të DWV International, duke filluar nga viti 2013. Përvoja e fituar rezultoi në këtë edicionin e dytë të Kurrikulës globALE të tanishme të rishikuar, si dhe në hapjen e faqes së internetit të KG dhe zhvillimit (të vazhdueshëm) të materialeve të ndryshme mbështetëse që mund të gjenden në këtë faqe (www.curriculum-globale.de).

3. Do konsiderata të natyrës globale të Kurrikulës globALE

Megjithëse lista e mësipërme përmban shembuj të projekteve që janë ndërkombëtare dhe shtrihen përtej kufijve kombëtarë, kjo nuk duhet ta errësojë faktin se deri më tash shumica e projekteve dhe përvojave lidhur me kualifikimin e arsimuesve të të rriturve kanë karakter kombëtar. Ato janë të synuara për një kontekst specifik kulturor e social dhe janë përftuar nga një bazë e tillë. Të kuptuarit se projekte të tilla shpesh përqendrohen në rolin dhe kompetencat e ngjashme, ka çuar në një varg projektesh që shtrihen përtej kufijve kombëtarë në Evropë, si në rastin me projektet e listuara më sipër. Megjithatë, në nivel global, duke u shtrirë në të gjitha kontinentet, nuk ka përpjekje të dukshme deri më sot për të nxjerrë profilet e kompetencave të përbashkëta ose të standardeve të kualifikimit dhe të zhvillohen programe të përbashkëta mbi këtë bazë. Ndërsa kjo pjesërisht vjen nga shkakut i kompleksitetit të bashkëpunimit ndërkombëtar, kryesisht i atribuohet kuptimeve të ndryshme të arsimit të të rriturve dhe të personelit që punon në këtë fushë.

Tema është ngritur në raste të shumta nëpër qarqet profesionale ndërkombëtare, duke përfshirë edhe CONFINTEA VI në Belém dhe luan një rol të rëndësishëm në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të). Në një perspektivë globale, rolet profesionale të arsimuesve të rritur mbulojnë një spektër shumë të gjerë. Ka mendime shumë të ndryshme se çfarë detyrash u përkasin kompetencave të një arsimuesi të të rriturve dhe se ç'kualifikime janë të nevo-

⁷ http://www.ginconet.eu/sites/default/files/Key_Competences_For_Adult_Educators.pdf (Qasja e fundit: 08.10.2015)

⁸ http://asemilhub.org/fileadmin/www.dpu.dk/ASEM/events/RN3/QF2TEACH_Transnational_Report_final_1_.pdf (Qasja e fundit: 08.10.2015)

jshme për këtë. Në disa vende, arsimuesit e të rriturve mund të jetë thjesht personel, kualifikimi kryesor i të cilëve konsiston në të qenit në gjendje të lexojnë dhe shkruajnë, e kombinuar kjo me aftësinë për t'ua mësuar këto aftësi të tjerëve. Vetëm në disa raste ka një formë të veçantë të përgatitjes së nevojshme për ta kryer këtë detyrë të mësimdhënies. Në shumë vende dhënia e informacionit shihet si detyra kryesore e arsimuesit të të rriturve, me fjalë të tjera shumë e ngjashme me konceptin tradicional të një mësuesi. Në të kundërtën, në vende të tjera mund të vërehet një ndryshim i qartë në rolin e arsimuesit të të rriturve drejt një funksioni udhëzues, mbështetës dhe lehtësues. Trajneri, lehtësuesi, moderatori, këshilltari dhe udhëzuesi janë emrat e roleve për arsimuesit e të rriturve që e pasqyrojnë këtë ndryshim. Ata gjithnjë e më shumë po fitojnë terren kundrejt termave klasikë si trajner (për të rritur), mësimdhënës (për të rritur) dhe arsimues për të rritur. Disa nga këta terma i japin theks më të madh funksionit informues dhe kompetencave, aftësive dhe zotësive që do të fitohen. Të tjerë i japin theks më të madh funksionit mbështetës dhe lehtësues të arsimuesit të të rriturve në vetëpërbushjen dhe zhvillimin e personalitetit të nxënësve.

Zhvendosja e lartpërmendur e fokusit nga funksioni ofruer e lehtësues ka pasoja edhe për mënyrën se si trajnimi për arsimuesit e të rriturve projektohet konceptualisht. Për shembull, në kontinentin e Amerikës së Jugut mund të vërehet një ndikim i fortë nga Paolo Freire. Me konceptin e tij të vetëdijes kritike (*conscientização*), Freire ka pasur ndikim të fortë mbi konceptin e arsimuesve të të rriturve në Amerikën Latine, detyra kryesore e të cilëve shihet si zhvillim i të reflektuarit kritik (*reflexão crítica*) në mesin e pjesëmarrësve.

Në shumë vende në zhvillim termi *shumëzuesit* përdoret shpesh. Ky term thotë shumë më tepër në lidhje me organizimin dhe strukturën e arsimit për të rritur sesa për përmbajtjen dhe funksionin e tij. Ky koncept është i dobishëm sepse liron veten nga lidhja me fusha të caktuara të përmbajtjes dhe kryesisht fokusohet në metodat e punës së edukimit me të rriturit.

Një tjetër ndryshim qëndron në ofruesit dhe kontekstet institucionale të arsimit për të rritur. Roli i arsimuesit të të rriturve ndryshon sipas asaj se a po kryhet puna në një sistem formal të arsimit, në forma organizative të drejtuara prej shtetit apo në sektorin e *shoqërisë civile*, ku organizatat joqeveritare ofrojnë programet e edukimit.

Kurrikula aktuale nuk është e bazuar në një prej koncepteve të roleve të lartpërmendura, por i mbulon si një e tërë në kuptimin e thelbit të tyre të përbashkët. Në praktikë, një ndarje e qartë e roleve të mësipërme nuk është gjithmonë e mundshme dhe rezultati shpesh është një përzierje e këtyre roleve. Kurrikula aktuale reflekton këtë prirje. Thelbi i përbashkët i roleve të ndryshme gjendet në kompetencat themelore që arsimuesit e të rriturve duhet t'i posedojnë, pavarësisht kontekstit kulturor, institucional ose tematik të punës. Kurrikula aktuale ndërtohet mbi këtë grup të kompetencave themelore. Duke specifikuar këto kompetenca, kjo domosdoshmërisht nënkupton një konceptim të caktuar të rolit të arsimuesit të të rriturve, d.m.th. kurrikula cakton një standard.

Duke pasur parasysh kushtet shumë të ndryshme për arsimin e të rriturve në vende dhe rajone të ndryshme, ky standard vetëdijshëm u referohet vetëm faktorëve të rezultateve - kompetencave që duhet të zhvillohen dhe të përcaktohen jospecifikisht në programin mësimor për sa i përket kontekstit. Lidhur me faktorët e të hyrave, d.m.th. përmbajtjes specifike dhe shembujve, kur zbatohet një program trajnimi, kurrikula ofron hapësirë të mjaftueshme për të përfshirë detaje specifike lokale, kulturore dhe të tjera në dizajnin konceptual. Pjesët e ndryshueshme të kurrikulës ndihmojnë për të kontribuar drejt kësaj.

Si me vetë arsimin e të rriturve, roli i arsimuesit të të rriturve varet nga konteksti, si dhe aspektet ekonomike, faktorët sociale dhe zhvillimet në fushën e arsimit. Kjo prandaj krijon kufizime të caktuara për një program mësimor që synon të aplikohet në të gjitha vendet, rajonet dhe fushat e studimit. Nga ana tjetër, një vetëdije për nevojën për profesionalizimin e arsimit të të rriturve tashmë ekziston në atë masë në gjithë botën sa *Korniza Belém për Veprim*, në kapitullin e saj për cilësinë e arsimit për të rritur, shprehimisht bën thirrje për "përmirësimin e trajnimit, ndërtimin e kapaciteteve, kushtet e punësimit dhe profesionalizimin e arsimuesve të të rriturve, p.sh. nëpërmjet krijimit të partneritetit me institucionet e arsimit të lartë, shoqatat e mësuesve dhe organizatat e shoqërisë civile."⁹ Po ashtu në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, një cak i rëndësishëm i Objektivit 4: *Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë dhe promovimi i të mësuarit tërëjetësor* është "që të rritet ndjeshëm ofrimi i mësuesve të kualifikuar, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar për trajnimin e mësuesve në vendet në zhvillim" deri më 2030. Janë këto tendenca globale, si dhe programet tashmë ekzistuese dhe zotimet e aktorëve dhe organizatave të ndryshme për ta rritur cilësinë e arsimit për të rritur me profesionalizimin e fushave që formojnë bazën për ndërmarrjen e këtij projekti të zhvillimit të një kurrikule globale. Kurrikula globALE ndjek qëllimin e përkrahjes së profesionalizimit të arsimit për të rritur duke specifikuar kompetencat themelore si një kuadër referimi për kualifikimin e arsimuesve të të rriturve në mënyrë të pavarur nga fushat e tyre specifike e punës. Ajo është globale, jo vetëm në kuptimin gjeografik, por edhe në kuptimin që përfshin trajnerë në edukimin e vazhdueshëm profesional, si dhe mësues që punojnë për shkrim-lexim, mësues që punojnë në shkollat shtetërore dhe aktivistë angazhuar në pedagogji të përfshirë në lëvizjet shoqërore.

9 <http://uil.unesco.org/home/news-target/belem-framework-for-action/0120c832d6d63fe6fb798a346c9b3419/> (Qasja e fundit: 08.10.2015)

4. Kurrikula globALE dhe Qasja e bazuar në të Drejtat e Njeriut

Kurrikula globALE ndjek Qasjen e bazuar në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ) në zhvillimin e bashkëpunimit:

“Në një QBDNJ, të drejtat e njeriut përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet individëve dhe grupeve me pretendime të vlefshme (mbajtësit e të drejtave) dhe aktorëve shtetërorë e joshtetërorë me obligimet e lidhura reciprokisht (bartësit e detyrave). Ajo identifikon mbajtësit e të drejtave (dhe të drejtat e tyre) dhe bartësit e detyrave (dhe detyrimet e tyre) dhe punon drejt forcimit të kapaciteteve të mbajtësve të të drejtave për të bërë kërkesat e tyre, si dhe të bartësve të detyrave për t'i përmbushur detyrimet e tyre”.¹⁰ Implikimi është se në vend se me qenë një shërbim që ofrohet në bazë të disponueshmërisë, arsimit është një e drejtë e garantuar që duhet të dorëzohet nga “bartësit e detyrave”.

Arsimi i të rriturve është përshkruar si një e drejtë themelore në raste të ndryshme, në veçanti në kuadër të Arsimit për të Gjithë (EFA), dhe si pjesë e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore:

“13(d) Arsimit themelor duhet të inkurajohet ose të intensifikohet sa më shumë të jetë e mundur për ata persona që nuk kanë marrë ose përfunduar gjithë periudhën e shkollimit të tyre primar”.

Në thelb, arsimimi i të rriturve është një nga parakushtet për të drejtën e vetëpërmbushjes dhe realizimit të potencialit të plotë të individit. Në kuadër të Kurrikulës Globale ky supozim është shprehur me konceptin e Cilësisë.

Për të siguruar të drejtën për arsim për nxënësit e rritur, tri grupe mbajnë përgjegjësi të ndryshme:

Roli i shtetit dhe i shoqërisë civile:

Cilësia në kuptim sistematik përfshin të gjitha elementet e procesit të të mësuarit dhe nxjerr në pah rëndësinë jetike të lehtësuesit të kualifikuar për proceset e të nxënësve. Për ta përmbushur detyrimin e vet për të siguruar të drejtën për arsim, shteti bashkë me shoqërinë civile duhet të sigurojë sisteme adekuate për t'u mundësuar individëve të angazhohen në të mësuarit gjatë gjithë jetës. Në nivel mesatar, stafi i kualifikuar duhet të trajnohet dhe t'i jepet kushte të përshtatshme pune, duke përfshirë marrjen e një shpagimi të arsyeshëm. Në nivel lokal, objektet e arsimit të të rriturve duhet të jenë të qasshme dhe të pajisura për të përmbushur nevojat e nxënësit të rritur. Me pak fjalë, shteti dhe shoqëria civile duhet të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për të nxitur të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Roli i arsimuesve të të rriturve:

Përfundimi i parë i Kombeve të Bashkuara, në bazë të RBA, është se “Njerëzit njihen si aktorë kyç në zhvillimin e tyre vetjak, para se pranues pasivë të mallrave dhe shërbimeve”. Si pasojë, arsimuesit e të rriturve duhet të përpiqen t'i fuqizojnë pjesëmarrësit për ta marrë përgjegjësinë e interesave të tyre dhe për t'i arritur aspiratat e tyre. Duke përdorë njohuritë e tyre metodologjike do t'u mundësojnë pjesëmarrësve me marrë një rol aktiv në procesin e të mësuarit dhe, në varësi të rrethanave përkatëse, t'i mbështesin ata për trajtimin e çështjeve të tyre me interes.

Roli i pjesëmarrësve:

Arsimimi nuk është produkt për t'u konsumuar, por proces për t'u përfshirë në të. Edhe nëse ofrohet mjedisi i përshtatshëm, akti i të mësuarit bëhet nga nxënësit, prandaj ata ndajnë përgjegjësinë për një përfundim të suksesshëm të të mësuarit. Kjo përfshin qëndrimet, kompetencat dhe sjelljet ndaj të mësuarit dhe në procesin aktual. Pjesëmarrja është proces i dyanshëm që do të funksionojë vetëm nëse mundësia për ta bërë këtë rrëmbehet.

Për pjesëmarrësit kjo nënkupton të drejtën dhe mundësinë për të filluar nxënien e vetëdrejtuar, si qarqet e nxënies, po qe e nevojshme.

Këto tri role plotësojnë njëri-tjetrin për të mundësuar mësimin kuptimplotë të të rriturve, nevojat, pritjet, dhe përvojat që duhet të komunikohen ndërmjet palëve për të siguruar një sistem të gjallë të të mësuarit tërëjetësor. Kurrikula globALE përpiqet të mbështetë arsimuesit e të rriturve për ta përmbushur rolin e tyre sa më mirë.

¹⁰ <http://hrbportal.org/the-human-rights-based-approach-to-development-cooperation-towards-a-common-understanding-among-un-agencies> (qasja a fundit: 08.10.2015)

5. Parimet e Kurrikulës globALE

Kurrikula Globale është ndërtuar mbi një numër parimesh të përgjithshme – orientimi nga kompetencat, orientimi kah veprimi, orientimi kah pjesëmarrësit dhe qëndrueshmëria e të nxënësve - që përshkruhen më poshtë.

Orientimi kah kompetenca

Siç u pohua më sipër, Kurrikula globALE ndërtohet mbi parimin e të qenit e orientuar kah kompetenca. Duke bërë kështu, lidhjet me tendencën që prej kohësh dominon në fushën e arsimit, përkatësisht duke synuar të jetë e orientuar kah “rezultati”, në përputhje me drejtimin e politikave arsimore. Debati lidhur me profesionalizimin dhe cilësinë në arsimim e vazhdueshëm është gjithashtu duke u orientuar drejt kësaj logjike.

Kompetenca është një koncept kompleks. Ky është faktor i përbashkët në të gjitha përkufizimet aktuale të termit kompetencë. Përkufizimi i OECD nga viti 2005 e përmbledh atë si më poshtë:

Kompetenca është më shumë se veç njohuri dhe aftësi. Ajo përfshin zotësinë për të përmbushur kërkesa komplekse, duke përdorë dhe mobilizuar burimeve psiko-sociale (përfshirë shkathtësitë dhe qëndrimet) në një kontekst të caktuar. (OECD 2005).

Prandaj, kompetenca përfshin një numër elementesh individuale (njohuri, aftësi, pikëpamje, etj), si dhe aftësinë për t'i sjellë këto në marrëdhënie me njëra-tjetrën dhe për ta zbatuar këtë në mënyrë të përshtatshme në situata të caktuara. Kompetenca në këtë kuptim i referohet aftësisë për të vepruar në kontekste të caktuara – p.sh. konteksti profesional i një arsimuesi të të rriturve.


Kurrikula globALE synon një aftësi të tillë veprimi, duke marrë parasysh elementet e mësipërme të kompetencës në kurrikul.

Kurrikula ofron për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive njohëse, si dhe aftësisë për vetëreflektim, për t'i shqyrtuar pikëpamjet dhe vlerat vetjake, dhe për të punuar në motivimin dhe aspektet emocionale. Një tjetër element i rëndësishëm që konsiderohet se ka rëndësi qendrore në programin mësimor është të kuptuarit për kontekstin më të gjerë shoqëror, që në mënyrë të konsiderueshme formon kushtet themelore për veprimet e çdo arsimuesi të të rriturve. Kjo përfshin jo vetëm kushtet politike dhe të kornizës ligjore të një vendi ose një rajoni, por edhe konceptet respektivisht mbizotëruese dhe pikëpamjet mbi arsimin e të rriturve, duke përfshirë, pikëpamjet e fshehura të pasqyruara. Kuptimi dhe paragjykimet që ekzistojnë në një shoqëri apo kulturë në lidhje me të nxënësve dhe mësimdhënies për të rriturit përfaqësojnë një kusht të lidhur me kontekstin që kontribuon në influencimin e veprimeve të arsimuesve për të rritur. Reflektimi i vetëdijshëm në këtë aspekt, prandaj formon një pjesë integrale të aftësive themelore të lidhura me kompetencën profesionale të punës së arsimuesve të të rriturve.

Orientimi kah veprimi

Kurrikula Globale përfshin jo veç aftësitë profesionale, por edhe aftësitë personale e sociale. Aplikimi i njohurive lidhet me mënyrën se si arsimuesit për të rriturit merren me nxënësve individuale ose grupet e nxënësve. Lidhet edhe me kapacitetin për të mësuarit tërëjetësor. Kurrikula ofron një përzierje të teorisë dhe të praktikës. Gjetjet teorike shkencore në procesin e të nxënësve të të rriturve formojë bazën dhe janë parakusht i rëndësishëm për zbatimin praktik dhe ushtrimet, si dhe reflektimin dhe zhvillimin e tyre me qëllim të krijimit të një praktike reflektuese. Në lidhje me zbatimin e programit mësimor, ndërlidhja e fazave të përvetësimit të njohurive teorike me fazat e ushtrimit praktik, me *provu* dhe me aplikun janë parakusht thelbësor. Vetëm përmes kësaj forme të ekspozimit do të jetë e mundshme të përmbushen kërkesat lidhur me një arsimues të të rriturve që është kompetent dhe vepron në mënyrë profesionale.

Një formë ideale e zbatimit të kurrikulës do të përfshinte praktikën profesionale si element i pandashëm. Kjo do të kërkonte ndarjen e sekuencave të mësuara gjatë një periudhe më të gjatë kohore, me fazat praktike për pjesëmarrësit mes njësive mësimore, d.m.th. të ndara sipas modelit të inputit - Përvoja praktike - Reflektim mbi praktikën:



Nga ana tjetër, në fazën e mëvonshme të inputi mund të ndërtohet përmbi rezultatet e reflektimit në praktikë, duke krijuar një lloj të procesit rrethor të përmirësimit, siç tregohet nga shigjeta në diagram.

Ndërmjet moduleve, pjesëmarrësit pritet të aplikojnë njohuritë e tyre të sapofituara në hartimin dhe zbatimin e njësive mësimore për të rritur. Ata duhet të përkrahen nga mentorimi dhe të inkurajohen të reflektojnë së bashku mbi praktikën e tyre të mësimdhënies.

Orientimi kah pjesëmarrësi

Orientimi kah pjesëmarrësi është parim qendror i arsimit për të rritur në të cilin bazohet edhe Kurrikula globALE. Kurrikula lejon liri të madhe në formën faktike të zbatimit. Kjo mund të përdoret për ta përshtatur përmbajtjen dhe metodat me kushtet dhe nevojat e pjesëmarrësve. Kjo tashmë vlen për modulet e kurrikulës bërthamë. Gama edhe më e gjerë e fleksibilitetit dhe rregullimit individual ofrohet nga pjesët e ndryshueshme të kurrikulës, që mund të dizajnohen lirisht sipas nevojave lokale, synimeve specifike.

Orientimi kah pjesëmarrësi përfshin edhe aspekte të tjera: rëndësinë dhe lidhjen me realitetin e përmbajtjes dhe metodave të të mësuarit për pjesëmarrësit, shqyrtimin e përvojës së tyre dhe njohurive ekzistuese, si dhe marrëdhënien mes mësimdhënësve dhe pjesëmarrësve në bazë të barazisë dhe respektit të ndërsjellë.

Gjatë fazës së zbatimit, këto parime kërkojnë, ndër të tjera, komunikim konstruktiv e motivues, organizimin fleksibil të kursit dhe një shumëllojshmëri metodash që mund të marrin parasysh nevojat dhe kërkesat e ndryshme.

Qëndrueshmëria e të nxënit

Arsimimi dhe nxënia e të rriturve duhet ta shtojë aftësinë e pjesëmarrësve për të mësuar në mënyrë efektive, në mënyrë që rezultatet e të nxënit të zgjasin shumë dhe të formojnë bazën për të mësuar të ardhmen. Prandaj, arsimimi i të rriturve ka për detyrë jo vetëm të japë mësim përmbajtjen, por edhe të ndihmojë nxënësit që të zhvillojnë metanijohjen (një aftësi për të reflektuar mbi procesin e të mësuarit të vetvetes) dhe t'i njohë ata me mjetet dhe teknikat e nevojshme për ta ndihmuar procesin e tyre të të nxënit të vetorganizuar. Një detyrë e rëndësishme është të rritet motivimi për të mësuar vazhdimisht, krahas me aftësitë e identifikimit, duke reflektuar dhe përmirësuar procesin vetjak të të nxënit. Është gjithashtu parakusht për mundësinë e aplikimit me sukses të njohurive dhe kompetencave në mjedise të ndryshme dhe e kombinimit të tyre me njohuri dhe kompetenca të reja.

Me nxënë aftësi dhe me nxënë efektivisht janë të nevojshme për ta bërë një nxënë të rritur nxënë gjatë gjithë jetës.

6. Vështrim i Kurrikulës globALE


Në këtë seksion komponentët individuale të Kurrikulës globALE dhe të strukturës së përgjithshme të kurrikulës mësimore shpjegohen në detaje. Shifrat lidhur me ngarkesën e orëve të punës dhe pikëve ECTS që jepen në pasqyrën e mëposhtme vlejné për rastin kur zbatohet një program krejt i programuar trajnimi KG. Në rast se RPL aplikohet për pjesë të caktuara të programit mësimor, shifrat që lidhen me ofrimet e mësimave mund të reduktohen krahas.

Krahasuar me edicionin e parë të Kurrikulës Globale, ngarkesa me orë është përshtatur – pra, kryesisht është ngritur – bazuar në përvojën e fituar në zbatimet e para pilot.

Gjithë kurrikulës i janë ndarë pikë 33 krediti ECTS¹¹ që përkohjnë me një ngarkesë prej përafërsisht. 830 orësh për pjesëmarrësit. Këto 830 orë janë shpërndarë mbi një sërë a) njësisish tematike dhe b) llojesh të ndryshme të formateve të të mësuarit

Në kuptimin e **njësive tematike** Kurrikula globALE përfshin:

- një modul hyrës,
- pesë module bosht tematike,
- 1-3 (varësisht nga madhësia) module zgjedhore.



11 <http://uil.unesco.org/home/news-target/belem-framework-for-action/0120c832d6d63fe6fb798a346c9b3419/> (Last Access: 08.10.2015)

Në lidhje me **formatet e të nxënit**, Kurrikula globALE përfshin:

- njësi mësimore brenda çdo moduli,
- vetëstudim individual i pjesëmarrësve brenda çdo modul,
- punë praktike e shoqëruar – pjesëmarrësit aplikojnë dhe reflektojnë mbi ç'kanë mësuar në ambiente të punës së vërtetë; mentorimi dhe udhëzimet ofrohen nga trajnerët
- pjesa e vlerësimit përfundimtar, që mund të jetë kombinim formatësh të ndryshme vlerësimi po që në çdo rast duhet të përfshijë pjesën praktike, pra, zhvillimin e konceptit të trajnimit nga pjesëmarrësi.

Duke i këqyrë **njësitë tematike**, raporti midis moduleve themelore në njërin anë dhe moduleve zgjedhore nga ana tjetër është përafërsisht 70:30, që d.m.th.: rreth 570 orë kohë të nxënit e pjesëmarrësve është shpenzuar në përmbajtje lidhur me pesë modulet kryesore tematike, ndërsa rreth 170 orë i përkushtohen temave të zgjedhura në mënyrë individuale dhe subjekteve që kanë të bëjnë me modulet zgjedhore.

Duke i këqyrë **formatet e të nxënit**, raporti midis njërive mësimore dhe vetëstudimit individual të pjesëmarrësve nga njëra anë dhe punës praktike e shoqëruar nga ana tjetër është 60:40, që d.m.th.: rreth 440 orë janë shpenzuar nga pjesëmarrësit në pjesëmarrjen në klasë, leximin individual dhe në ushtrime, ndërsa 300 orë janë shpenzuar nga pjesëmarrësit në zbatimin e mësimit në mjedise të punës së vërtetë dhe duke reflektuar mbi të, me mbështetjen e trajnerit i cili siguron udhëheqje dhe mentorim gjatë këtij procesi.

Siç mund të shihet nga kjo shpërndarje, **puna praktike e shoqëruar** ka rëndësi të madhe në kuadër të Kurrikulës globALE. Puna praktike e shoqëruar mundet, p.sh. të marrë format e mëposhtme:

- Përvoja e trajnimit përdoret për ta zbatuar teorinë në jetën e vërtetë dhe për t'i zhvilluar më tej e mprehur kompetencat.
- Reflektimi mbi “komunitetet e praktikës”, vëzhgime të ndërsjella, përcjellja e një posti dhe reagime ndaj trajnimeve japin pamjen e nevojshme të jashtme për t'i njohur fuqitë dhe dobësitë e stilit vetjak të trajnimit.
- Mentorimi dhe udhëheqja nga trajnerët ofrojnë Kurrikulën globALE që ndihmon për t'i trajtuar sfidat në *praktikën* e arsimit për të rritur dhe për të përfutur nga njohuritë e kolegëve me përvojë.
- Përgatitja, planifikimi dhe rishikimi i sesioneve të trajnimit është parakusht i domosdoshëm për performancën profesionale të trajnerëve dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit.

Shpërndarja e punës praktike të shoqëruar ndërmjet **moduleve të ndryshme tematike** nuk është fikse përfundimisht. Brenda rregullave të caktuara, pjesëmarrësit mund të zgjedhin prioritetet e tyre këtu. Rregullat e vetme kufizuese janë:

- 250 orët e punës praktike të shoqëruar duhet të kryhet në kuadër të pesë moduleve kryesore, dhe 50 orë në kontekstin e moduleve zgjedhore.
- Për çdo modul një minimum prej 25 dhe një maksimum prej 120 orësh pune praktike të shoqëruar mund të akredituar në drejtim të Kurrikulës Globale. Ky rregull është për të siguruar që një gamë mjaft të gjerë tematike është e mbuluar nga puna praktike dhe për të parandaluar që e gjithë sasia e punës është i përkushtuar për një temë të vetme.

Veç kësaj, ka një mundësi që pjesëmarrësit me përvojë pune paraprake, si arsimues për të rritur të ketë 60 orë të kësaj përvoje të akredituar në drejtim të kërkesës së përgjithshme të 300 orëve të punës praktike.

Për një vështrim të shpërndarjes së orëve dhe pikëve përkatëse të kreditit ndërmjet njërive të ndryshme tematike dhe formateve të të mësuarit shih tabelën e mëposhtme.

Titulli i modulit	Përbërja kryesore (titujt)	Ngarkimi me punë	ECTS
Moduli 0: Hyrje	<ul style="list-style-type: none"> • Informata mbi Kurrikulën globALE • Informata mbi trajnimin • Informata mbi ofruesin e trajnimit • Informata mbi pritshmëritë e pjesëmarrësve • Pritshmëritë e globALE kundrejt pjesëmarrësve • Ndërtim marrëdhëniesh 	15 orë	0,5
Moduli 1: Qasje në Arsimin e të Rriturve	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptuarit e një llojshmërie dhe diversiteti të arsimit të të rriturve • Arsimi i të rriturve në kontekst shtetëror dhe global • Arsimi i të rriturve si profesion dhe roli i arsimuesit të të rriturve në kuptimin e Kurrikulës globALE 	32 orë udhëzimi (≈4 ditë) 32 orë studimi dhe vlerësimi individual	2,5
Moduli 2: Mësimdhënia e mësim-nxënia te të rriturit	<ul style="list-style-type: none"> • Teoritë dhe arsytet e të nxënit • Aktivitetit didaktik në arsimin e të rriturve • Format e dijes • Nxënia e të rriturve • Motivim i arsimit 	32 orë udhëzimi (≈4 ditë) 32 orë studimi dhe vlerësimi individual	2,5
Moduli 3: Komunikimi dhe dinamika grupore te Arsimit i të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi në arsimin e të rriturve • Dinamika grupore te arsimit i të rriturve 	32 orë udhëzimi (≈4 ditë) 32 orë studimi dhe vlerësimi individual	2,5
Moduli 4: Metodat e Arsimit të të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> • Integrimi i metodave në udhëzim • Pasqyrë e metodave 	32 orë udhëzimi (≈4 ditë) 32 orë studimi dhe vlerësimi individual	2,5
Moduli 5: Planifikimi, organizimi dhe vlerësimi i arsimit të të rriturve	<ul style="list-style-type: none"> • Fazat e ciklit profesional të aktivitetit të një arsimuesi të të rriturve • Vlerësimi i nevojave • Planifikimi • Organizimi • Evaluimi • Sigurimi i cilësisë 	32 orë udhëzimi (≈4 ditë) 32 orë studimi dhe vlerësimi individual	2,5
Modul(et) zgjedhor(e)	<ul style="list-style-type: none"> • Rajonal-geografik • Specifik për grupin e synuar • Specifik për lëndën • Specifik për situatën • Specifik për rregulloren 	64 orë udhëzimi 56 orë studimi dhe vlerësimi individual	5
Zbatimi praktik dhe ushtrimet: 300 orë			
- Modulet themelore: 250 orë, modulet zgjedhore: 50 orë			
- Shpërndarja mes moduleve mund të ndryshojë; minimumi për modul themelor: 25 orë, maksimumi për modul themelor: 120			
- me u përfshi: pjesëmarrësit përgatisin, japin mësim dhe reflektojnë mbi të paktën 3 mësimet të vetat (75 orë)			
- deri në 60 orë të përvojës paraprake të trajnimit të pjesëmarrësve mund të llogaritet si zbatim praktik			
Vlerësimi përfundimtar (p.sh koncepti i trajnimit dhe zbatimi praktik): 75 orë			3
Gjithsej module bazë: 570 orë		160 orë udhëzimi 160 orë studimi dhe vlerësimi individual	12,5
		250 orë zbatim praktik	10
Gjithsej modul(e) zgjedhor(e): 170 orë		64 orë udhëzimi 56 orë studimi dhe vlerësimi individual	5
		50 orë zbatim praktik	2
Gjithsej module hyrëse dhe vlerësim përfundimtar: 90 orë		15 modul hyrës 75 vlerësim përfundimtar	3,5
Gjithsej:		830 orë	33 ECTS

1 to max. 2 vite

Modulet duhen pa si njësi të pavarura. Sidoqoftë, ka shumë ndërlikime tematike dhe faktorë përafres që duhen zgjedhë e marrë parasysh kur të zbatohet kurrikula.

Kjo vlen veçmas për marrëdhëniet mes moduleve “Mësimnxënia dhe mësimdhënia për të rriturit” dhe “Metodat e arsimit për të rriturit”. Moduli i metodave bazohet në modulin “Mësimnxënia dhe mësimdhënia për të rriturit” i cili synon të japë një kuptim të parimeve themelore didaktike. Ndërsa fokusi në këtë modulin “Mësimnxënia dhe mësimdhënia për të rriturit” është në parimet teorike që duhet të ilustrohen dhe të reflektohen në përdorimin e shembuj individualë specifikë (metoda), kjo vlen anasjelltas në modulin “Metodat e arsimit për të rriturit”: moduli shërben për të ngritur një repertor të gjerë të metodave për objektiva të ndryshëm praktikë përbrenda veprimeve didaktike të mësuesit. Kjo nuk d.m.th. se moduli duhet të kufizohet krejtësisht për të paraqitur metoda testimi. Përkundrazi, reflektimi mbi metodat e ekzaminuara dhe lidhja e tyre përsëri me parimet teorike të fituara është shprehimisht e nevojshme. Modulet “Mësimnxënia dhe mësimdhënia për të rriturit” dhe “Metodat e arsimit për të rriturit” kështu në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë ndarje të rreptë të teorisë dhe praktikës në dy njësi të veçanta, por krijojnë fusha të fokusimi brenda një marrëdhënie teori-praktikë që gjithmonë do pa si një njësi.

Për t’u siguruar se aftësitë e nevojshme janë fituar, pjesëmarrësit duhet të dëshmojnë:

- Aftësi për të hartuar një kurs të zgjedhur prej tyre në përputhje me nevojat dhe kërkesat e pjesëmarrësve të tyre;
- Aftësi për të lehtësuar një seancë mësimi në përputhje me parimet e dinamikës në grup, psikologjisë së të mësuarit të të rriturve, etj.

Të dy aftësitë mund të konstatohet nga trajnerët përgjegjës për zbatimin e Kurrikulës Globale duke shqyrtuar planin e trajnimit/dokumentet e planifikimit dhe duke vështruar një sesion trajnimi të ofruar nga pjesëmarrësi.

7. Do udhëzime për zbatimin e Kurrikulës globALE

Disa parakushte të përgjithshme sa i përket pjesëmarrësve, trajnerëve dhe ofruesve të trajnimit janë përshkruar më poshtë. Për udhëzime më të hollësishme referojuni materialeve shtesë në faqen e internetit të KG ose kontaktoni ekipin KG në Bon.

7.1 Çështje ndërsektorale

Ka disa tema dhe parime që mund të jenë subjektet e moduleve zgjedhore, por meqë ato janë globalisht të vlefshme, siç vihet në dukje në shumë dokumente ndërkombëtare, përfshirë Kornizën Belém për Veprim, ato duhet të konsiderohen si çështje ndër-sektorale (për shembull si pjesë e rolit social të arsimuesit të të rriturve, si pjesë e materialit mësimor, si temë për diskutim në grup ose disa metoda të tjera, etj.). Këto tema/parime janë:

- **Qasja sensitive ndaj gjinisë** në arsimin dhe arsimimin e të rriturve, e cila duhet t’u mundësojë pjesëmarrësve të paraqesin barazinë gjinore dhe elementet kryesore të menaxhimit të diversitetit në praktikën e tyre arsimor. Trajnimi duhet të rrisë vetëdijesimin gjinor, ndjeshmërinë kulturore dhe transparencën për diversitetin si dhe aftësinë për të punuar në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë. Pjesëmarrja, përfshirja dhe barazia, fuqizimi i grave dhe grupeve të tjera të cenueshme - këto janë në thelbin e profilit për një arsimues të të rriturve.
- **Zhvillimi i qëndrueshëm dhe ndryshimet klimatike** janë trajtuar në kontekstin e të drejtave të njeriut, të drejtave të brezave të ardhshëm dhe përgjegjësi ndaj tyre e ndaj mjedisit. Siç pohon Shoqata e Paqësorit Jugor Aziatik për Arsimin Themelor dhe të të Rriturve (ASPBAE): “Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm është një kornizë më e madhe e arsimit e cila kërkon të integrojë vlerat, parimet dhe praktikën e zhvillimit që adresojnë problemet sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore me të cilat njerëzit përballen në shekullin e 21-të.”¹²
- Siç është cekur në *Kornizën Belém për Veprim*, edukimi dhe arsimimi i të rriturve duhet të kontribuojë në **zhvillimin e qëndrueshëm, paqe dhe demokraci**. Prandaj zbatimi i kurrikulës bazohet në vlerat emancipuese, humaniste dhe demokratike, zhvillimin e aftësisë së pjesëmarrësve për të punuar në mënyrë demokratike, me mendje të hapur, të hapur dhe të ndjeshëm ndërkulturalisht. Vizioni i një “bote të konflikteve të dhunshme që zëvendësohet nga dialogu dhe kultura e paqes së bazuar në drejtësi” - siç përshkruhet në Deklaratën e Hamburgut për Mësimin e të Rriturve / CONFINTEA V¹³ – kërkon krijimin e një atmosfere të tillë gjatë trajnimit të tyre dhe aftësinë për të frymëzuar pjesëmarrësit që të punojnë ngjashëm për arsimin e të rriturve në praktikën vetjake.

12 <http://www.aspbae.org/node/46> (Qasja e fundit: 08.10.2015)

13 <http://www.unesco.org/education/uie/confintea/declaeng.htm> (Qasja e fundit: 08.10.2015)

7.2 Elementet themelore të përbashkëta dhe të ndryshueshme

Një kurrikul globale për *Arsimimin dhe nxënien e të rriturve* që mund të përdoret në të gjithë botën, përtej kufijve, mund të duket detyrë e pamundshme duke pasur parasysh kontekstet sociale dhe kulturore jashtëzakonisht të ndryshme. Megjithatë, iniciatorët e kësaj kurrikule besojnë se roli i arsimit të të rriturve siç konceptohet në Kurrikulën globALE është i bazuar në një grup vlerash e parimesh që janë me rëndësi në gjithë botën. Nga perspektiva e Kurrikulës globALE, faktorët që kanë të përbashkët në mbarë botën arsimit për të rritur janë:

- Detyra e përkrahjes së proceseve të mësimnxënies së të rriturve;
- Detyra e promovimit të emancipimit dhe vetëpërcaktimit të nxënësve të rritur;
- Njohja e nxënësve të rritur si persona “në moshë”, pra të pjekur dhe përgjegjës që vendosmërisht (bashkë-) përcaktojnë procesin e vet të nxënies.

Për Kurrikulën globALE këto parime themelore formojnë një bazë esenciale. Për më tepër, kurrikula ofron gamë të mjaftueshme për ndryshueshmëri, duke lejuar që nevoja të ndryshme të plotësohen në raste individuale. Diversiteti ekzistues i kulturave dhe zakoneve, si dhe korniza shoqërore, politike dhe ekonomike njihen në konceptin e Kurrikulës globALE dhe janë marrë në konsideratë. Kjo pjesërisht në sajë të fushës së lirisë së projektimit brenda pesë moduleve kryesore dhe në veçanti, pjesës së ndryshme të kurrikulës, moduleve zgjedhore, e cila hartohet krejt lirshëm dhe është përgjegjëse për 30 për qind të programit mësimor të përgjithshëm.

Ndryshueshmëria dhe liria e dizajnit mund t'i referohen aspekteve shumë të ndryshme:

- Aspekteve rajonale-gjeografike, duke mundësuar që të shprehen nevojat e veçanta lokale. Ajo që e bën të veçantë mjedisin lokal - qoftë kjo një traditë e veçantë, temë e nxehtë për komunitetin lokal ose konceptet e veçanta që janë më të rëndësishme në rajone individuale, shtete, kontinente sesa në të tjerat - e gjithë kjo mund të merret parasysh.
- Aspekteve specifike për grupin e synuar (grupi i synuar këtu i referohet të rriturve me të cilët punojnë pjesëmarrësit e kursit brenda funksionit të tyre si arsimit të rritur, ose aktualisht, ose dikur më vonë): Varësisht se cilat parakushte dhe karakteristika (gjinia, mosha, arsimit, përvoja profesionale, përkatësia etnike, invaliditeti, etj.) shqyrtohen nga grupet e synuara përkatëse specifike për lokalitetin ose cilat interesat dhe qëllime specifike janë duke u ndjekur përmes pjesëmarrjes së tyre në një program arsimor (shkrim-lexim, fuqizim, etj.), për këtë qëllim fushat kryesore mund të krijohen në mënyrë të shënjestruar në pjesën e ndryshueshme të kurrikulës.
- Aspekteve të temave dhe specifike për lëndën: këto ofrojnë një spektër të gjerë të mënyrave të mundshme për ta përpunuar kurrikulën konkretisht - nga vendosja e fushave kyçe të fokusit, për shembull, në arsimin bazë, ose në degë të ndryshme të arsimit profesional e deri te seminarët klasike brenda traditës së edukimit liberal. Nëse kërkohet, kjo mund të kombinohet me komponentët e njohurive specifike për profesionet dhe elementet didaktike të lëndës (p.sh. didaktikë gjuhësore, shkrim-lexim ose të ngjashme).
- Detyrave të menaxhmentit në arsimimin e të rriturve: komponenti thelbësor i kurrikulës globALE fokusohet në punën e mësimdhënies që zhvillohet në kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit. Detyrat organizative, planifikuese e koordinuese mbulohen vetëm deri në masën që janë direkt të nevojshme për me përgatitë dhe krye një punë të tillë të mësimdhënies. Do të jetë e mundshme të përdoret pjesa e ndryshueshme e kurrikulës për të mbuluar një spektër më të gjerë detyrash të arsimit të të rriturve duke vënë një fokus në planifikimin, organizimin dhe detyrat e të lidhura me menaxhmentit që kanë të bëjnë me institucionin ose nivelin e programit.
- Aspekteve specifike për situata: mundësi të mëtejshme mund të rezultojnë nga situata të veçanta - një projekt i caktuar që kërkon profil të veçantë arsimuesi për të rriturit; një situatë krize, p.sh. në zonat e krizës politike, në të cilat duhen njerëz që mund të kryejnë programe ndërhyrjeje në arsim në mënyrë të shënjestruar.
- Aspekteve specifike për rregulloren: në disa raste standardet e kualifikimit për arsimuesit e të rriturve mund të parashkruhen, qoftë me legjislacion kombëtar ose nëpërmjet rregulloreve në nivel ofruesi të arsimit. Pjesa e ndryshueshme e kurrikulës mund të përdoret për të bërë një përshtatje të standardeve ekzistuese të kualifikimit.

30 përqindëshi, që përshkruhet për pjesën e ndryshueshme të kurrikulës përfaqëson një përqindje udhëzuese. Edhe kjo mund të rregullohet për të përmbushur kushtet specifike të vendit. Për shembull, një standard ekzistues mund ta shohë të arsyeshme të shtojë një numër të madh pjesësh të tjera të ndryshueshme. Në raste të tjera është e mundshme që përvojë paraprake dhe kompetencat e pjesëmarrësve të mund të merren parasysh dhe të kreditohen drejt kurrikulës së përgjithshme. Në raste të tilla, përqindja e mësimi të strukturuar dhe njësitë mësimore që duhet të kompletohen në pjesën e ndryshueshme të kurrikulës mund të reduktohen krahas.

Në asnjë rrethanë nuk duhet kombinimi i kurrikulës bërthamë me pjesët e ndryshueshme të kryhet në mënyrë thjesht mekanike. Të dyja pjesët duhet të ndërlidhen me njëra tjetrën. Pjesët e ndryshueshme mund të shërbejnë për t'i çuar përpara ose zgjeruar kompetencat e fituara në pjesën thelbësore të kurrikulës. Ato mund t'i përkushtohen veçanërisht që të paraqesin dhe reflektojnë përmbajtjen e adresuar në pjesën thelbësore të kurrikulës. Pjesa e ndryshueshme mund të fokusohet në analizimin e shembujve të rasteve ose të merret me metodat e specializuara dhe aspektet e veçanta të aplikimit. Kjo rezulton në një gamë të gjerë mundësish për përshtatjen e kurrikulës globALE me kontekstin specifik të aplikimit, qoftë kjo në shtet, rajon, grupin e synuar, situatën a zonën, shkurt: me vendosë trajnime të përshtatura për audienca të ndryshme. Mbi të gjitha, ideja e rekomanduar që pjesëmarrësit të kryejnë praktikën e tyre mësimdhënëse, si dhe pjesën individuale të studimit, është mundësi e mirë për akomodimin e diversitetit gjeografik dhe kulturor, nevojat e ndryshme dhe natyrat e ndryshme të arsimit të të rriturve.

7.3 Zhvilloni versionin tuaj “lokal” të KG

Kur Kurrikula globALE të jetë prezentuar, ajo duhet të përshtatet me kontekstin specifik institucional dhe profesional për të mbështetur zhvillimin e sistemit në fjalë të arsimit për të rritur. Kjo nënkupton që Kurrikula globALE nuk mund të ekzistojë si një zgjidhje “më vete”, por ka nevojë të ngulitet në kontekstin ekzistues.

Përgjithësisht rekomandohet që:

- Të ndërlidhen kurrikulat lokale me skemat e trajnimit që tashmë ekzistojnë.
- të përfshihen të gjitha palët e interesuara të mundshme.
- të harmonizohet Kurrikula globALE me politikat kombëtare dhe kërkesat lokale.
- të bashkëpunohet regionalisht.

Para përshtatjes së Kurrikulës globALE me kontekstin lokal, sugjerohet të identifikohen lëndët dhe konceptet që tashmë ekzistojnë; këto duhet të vijnë me aktorët e rëndësishëm të bashkangjitur. Këto janë zakonisht:

Qeveria: Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe/ose Ekonomisë, Ministria e Çështjeve Sociale, Ministria e Planifikimit

Institucionet Ndërkombëtare: UNESCO, Grupi Sektorial i Koordinimit për Arsim, Fushata Globale për Arsimin, OJQ-të përkatëse dhe zbatuesit ndërkombëtare (listat janë në dispozicion në devdir.org)

Organet arsimore: Universitetet, Shkollat Profesionale, Qendrat e Trajnimit të Mësimdhënësve, Qendrat e Arsimit të të rriturve dhe Organizatat e tyre përkatëse ombrellë, Shoqatat e Trajnerëve

Organizatrat që mund ta mbulojnë njëra-tjetrën: Odat, OJQ-të - p.sh. me punën në zhvillimin rural

Rendimenti i kësaj harte do të ndryshojnë konsiderueshëm në varësi të traditave lokale, prioritetëve dhe nevojave. Bazuar në këtë vlerësim, një grup pune duhet të formohet për të siguruar harmonizimin me politikat e qeverisë dhe të donatorëve, me ndërlidhje të aktorëve që ofrojnë programe të ngjashme, dhe duhet të krijohet qasja tek ekspertët dhe burime në mënyrë që të planifikohet dhe të zbatohet Kurrikula globALE. Zhvillimi i konceptit të trajnimit duhet të diskutohet me anëtarët e grupit të punës dhe të zbatohet duke përdorë sa më shumë burimet e përbashkëta.

Para zbatimit, plotësimi i nevojave të aktorëve të ndryshëm, infrastruktura në dispozicion dhe burimet duhet të shqyrtohen me kujdes. Në disa rajone, bashkëpunimi rajonal mund të zvogëlojë shpenzimet me zhvillimin e përbashkët të materialeve të trajnimit dhe përdorimit të TIK-ut.

7.4 Zbatimi i trajnimit KG

Mbasi kurrikula strukturohet në mënyrë të orientuar drejt të kompetencës, të dhënat e listuara të kornizës organizative në kohëzgjatjen dhe gamën e moduleve individuale përfaqësojnë rekomandimet që bazohen në përvojën e fituar nga praktika. Një kohëzgjatje e shkurtër është e mundshme nëse pjesëmarrësit tashmë kanë një njohuri themelore të nivelit të caktuar. Për organizimi e zbatimit të kurrikulës në njësi mësimore në kuptimin e kohëzgjatjeve, në parim janë të mundshme një numër modelesh shumë të ndryshme, duke filluar nga një kurs intensiv me orar të plotë deri te ndarja e programit në njësi të shkurta mësimore gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Vlerë e madhe duhet t'i vihet lidhjeve organike të njësive mësimore me fazat dhe aktivitetet për studimet individual të pjesëmarrësve. Një skenar ideal do të ishte modeli në të cilin "fazat e të vetëmësuarit", p.sh. për të testuar dhe reflektuar mbi atë që është mësuar, përfshihen ndërmjet dy fazave të mësimdhënies. Për modulet dedikuar mësimdhënies, nxënies dhe metodave, kjo do të kërkonte idealisht që pjesëmarrësit tashmë të punonin në mësimdhënie. Fazat e mësimave mund t'i përgatisin fazat e vetëmësimit dhe të mbështesin zbatimin profesional të asaj që është mësuar përmes punës së shënjestruar dhe detyrave për reflektim. Kësisoj, teoria dhe praktika mund të lidhen bashkë në mënyrë optimale.

Për sa i përket rendit të moduleve: rekomandohet të fillohet me 1 dhe 2 module meqë ofrojnë njohuri themelore teorike ata dhe të kuptuar të të mësuarit dhe të arsimit të të rriturve. Rendi i moduleve 3 deri në 5 mund të trajtohet në mënyrë më fleksibile.

Sa për parakushtet e nevojshme për vënien e trajnimit KG, duhet të respektohen disa rregulla të përgjithshme të përshkruara më poshtë:

Kërkesat fizike

Kërkesat fizike sa u përket dhomave ku do të kryhen fazat mësimore bazohen në parimet e mësimit të të rriturve. Të rriturit kërkojnë dhoma posaçërisht të përshtatura. Kjo kursesi nuk nënkupton se dhoma duhet të jetë tepër e mëdha, e rehatshme ose e pajisur me orëndi të cilësisë së lartë. E rëndësishme është që të mos jenë vetëm klasa klasike të projektuara që mësuesit të ligjërojnë nga kryet e klasës e nxënësit të ulen tradicionalisht prapa në tavolinat për nxënësit. Të rriturit duhet ndjehen të lirshëm në klasa dhe të kenë mjaft hapësirë për të punuar në grupe të vogla dhe për ushtrime. Sa për mjetet konkretizuese, mësuesit duhet të ketë media të duhura dhe mjete teknike në dispozicion, pa u specifikuar kjo në detaje këtu. Qëllimi është të ketë një nivel minimal mjetesh, që përveç një dërrase të zezë duhet të përmbajnë një tabelë të bardhë, flip-tabelë, tabela për ngjitje dhe mjetet e lehtësuesit. Sa të jetë e mundshme, një kompjuter me një video-projektor duhet të sigurohen, sidomos në funksion të kërkesave përgjithësisht të pranuar për aftësim në TIK.

Pjesëmarrësit

Nuk ka kërkesa për kualifikim që të jenë përcaktuar për pjesëmarrësit. Megjithatë, mbasi kurrikula vë një theks të fortë në zbatimin dhe reflektimin mbi punën praktike, pjesëmarrësit duhet të aplikojnë kompetencat e tyre të fituara në situata reale. Idealisht, pjesëmarrësit tashmë duhet të punojnë në një kapacitet të mësimdhënies në arsimin e të rriturve, kur ta fillojnë programin e tyre të kualifikimit. Në të gjitha rastet është e nevojshme që ata të kenë mundësi ta fillojnë një punë të tillë gjatë programit të kualifikimit.

Trajnerët

Kërkesat e vëna mbi individët që aplikojnë kurrikulat në kapacitetin e planifikimit dhe mësimdhënies (instrukturët, trajnerët, etj.), nuk përcaktohen zyrtarisht. Megjithatë, një sasi njohurish të arsimit të rriturve dhe përvajave personale me punë në arsimin e të rriturve është thelbësore si kërkesë minimale. Lidhur me elementet e veçanta, specialistë nga fusha përkatëse (p.sh. psikologji ose gjuhë) pa përvajë të veçantë në arsimin e të rriturve, mund të konsiderohen por duhet të përfshihen në një ekip me trajnuesit me përvajë që të sigurohet një cilësi e programit.

Ofruesit e trajnimeve

Institucionet zbatuese të Kurrikulës globALE duhet të posedojnë profilin e duhur profesional (në aspektin e njohurive, lidhjeve me trajnerët dhe pjesëmarrësit, si dhe infrastrukturën) për të ofruar një mjedis cilësor të të mësuarit për diplomantët e Kurrikulës globALE. Mbasi një organizatë e vetme shpesh nuk do të mund të ofrojë të gjitha elementet e mbuluara nga kurrikula, qasjet e përbashkëta jo veç do ta përmirësojnë trajnimin, por të nxisin krijimin e rrjeteve dhe shkëmbimin e njohurive në arsimin e të rriturve.

Një vendim i vetëdijshëm është marrë jo për ta kuantifikuar këtë fushë në detaje të mëtejshme për ta ndaluar implementimin e Kurrikulës të mos dështojë për shkak të kërkesave formale, çka në disa pjesë të botës do të ishte praktikisht e pamundshme të përmbushet për shkak të mungesës së strukturave të nevojshme.

8. Sigurimi dhe mbikëqyrja e cilësisë

Mbikëqyrja dhe përkrahja

DIE dhe DWV International do të përkrahin zyrtarisht zbatuesit e DWV International si dhe subjekte të tjera të interesuara, duke ofruar udhëzime për ngritjen e programit të trajnimit, hulumtimin dhe zhvillimin e materialeve të trajnimit, duke gjetur lehtësuesit dhe trajnuesit e përshtatshëm si dhe duke dhënë këshilla të vazhdueshme nëse ndonjë problem haset gjatë zbatimit.

Duke i përkrahë partnerët nga afër, do të mblidhet përvoja e dorës së parë në lidhje me përshtatshmërinë e përmbajtjes dhe strukturës së Kurrikulës globALE. Për më tej, ajo do t'i mundësojë ekipit që të njohë më thellë artet e zbatimit të kurrikulës në praktikë, duke qenë në gjendje të mbledhë mësimet e nxjerra për aplikim në të ardhmen.

Bashkë me dokumentacionin e skenarëve të zbatimit, mbështetja e ngushtë jo veç do të kontribuojë për një cilësi të lartë të programeve, por do të sigurojë edhe që shanset, pengesat dhe zhvillimet, bashkë me rrjetin formal të indikatorëve, të mund të futen në procesin e përmirësimit të Kurrikulës globALE.

Treguesit e cilësisë për kurrikulën dhe sistemin e mbikëqyrjes

Pikënisja për vlerësimin e Kurrikulës globALE është, siç u tha, e Drejta për Arsim, që do të shfrytëzohet si kornizë referenciale për kriteret në mënyrë që të vlerësohet asistenca për zhvillim e Komisionit të Asistencës për Zhvillim të OECD¹⁴

14 <http://www.oecd.org/dac/evaluationofdevelopmentprogrammes/49756382.pdf> (Qasja e fundit: 08.10.2015)

Kriteri	Pyetje udhëzuese	Adresat:	Kriteri mbikëqyrës	Burimi	Komente
Rëndësia	Sa kontribuon Kurrikula globALE për përmbushjen e nevojave shoqërore të vendit a rajonit në fjalë?	Pjesëmarrësit, trajnerët e partnerët e përfshirë në zbatim të Kurrikulës globALE	Sa ishte shqetësues niveli profesional i trajnerëve në vendin përkatës? Zbatimi i Kurrikulës globALE a i ka plotësuar prioritetet e organizatave partnerë? A ishte shkëmbimi i ndërtimit të kapaciteteve me interes për partnerët?	Intervista grupore ose individuale, pyetësorë	Rëndësia në nivele shoqërore përcaktohet shumë nga përshtatshmëria e 30% moduleve zgjedhore dhe fokusit të përgjithshëm të partnerëve
Efektshmëria	Sa ia kanë dalë qëllimet: <ul style="list-style-type: none"> me shtu profesionalizmin e arsimuesve të të rriturve duke ofruar një kornizë të përbashkët referenciale me përkrahje ofruesit e arsimit të të rriturve në hartimin dhe zbatimin e programeve trajnim-për-trajnerë me nxitë shkëmbim njohurish dhe mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet arsimuesve të të rriturve në mbarë botën? 	Pjesëmarrësit, trajnerët dhe partnerët e përfshirë në zbatimin e Kurrikulës globALE	Sa dhe në ç'fusha është përmirësuar aftësia trajnuese e pjesëmarrësve për shkak të trajnimit? A kanë nxënë pjesëmarrësit kompetencat që duhej? Dizajni dhe zbatimi i programit të trajnimit si përfituan nga Kurrikula globALE? Sa kontribuoi Kurrikula globALE për shkëmbimin e dijes?	Intervistat grupore e individuale, pyetësorët (idealisht të dhëna themelore të pjesëmarrjes)	Efektshmëria formësohet fort nga cilësia e vetë programit të trajnimit në kuptimin e trajnerëve dhe të konceptit.
Efikasiteti	Me çfarë masash mundën nevojat e trajnimit të trajnerëve pjesëmarrës me u përmbushë me kosto të ulët? Çfarë mënyrash të tjera më efikase mund të përdreshin në përkrahje të partnerëve për të zhvilluar programe TiT? Si mundet shkëmbimi i njohurive ndërmjet arsimuesve të të rriturve të arrihet më lirë?	Pjesëmarrësit, trajnerët dhe partnerët e përfshirë në zbatimin e Kurrikulës globALE	Cilat ishin vështirësitë në zbatimin e Kurrikulës globALE në praktikë? Identifikimi i aktiviteteve alternative me përlogaritje kostosh për t'i përmbushë nevojat e trajnerëve, duke zhvilluar skemat e trajnimit, dhe nxitë shkëmbimin e njohurive.	Stuhi idesh me palët e interesuara	Efikasiteti i mënyrës se si koncepti i trajnimit po zhvillohet vështirë dallohet nga efikasiteti i mënyrës se si ai ofrohet.
Ndikimi	A ka përfituar grupi i synuar tretësor nga trajnimi në kuptimin e pjesëmarrjes dhe/ose përmirësimit të kushteve të jetës?	Pjesëmarrësit në trajnimin e tyre	A ishte përmbajtja e trajnimit e përshtatshme dhe e ofruar në mënyrë profesionale? A u nxit pjesëmarrja?	Pyetësorët	Mangësia e atribuitit vështirë me u përmbushë si përmbajtje trajnim, rethanat dhe mënyra e ofrimit e zbehim ndjeshëm cilësinë e Kurrikulës globALE.
Qëndrueshmëria	Si përdoret ende Kurrikula globALE nga partnerët pasi të mbarojnë fondet? Lidhjet e vëna ndërmjet arsimuesve të të rriturve ende përdoren një vit pas projektit?	Trajnerët dhe partnerët e përfshirë në zbatimin e Kurrikulës globALE	Njësoj si pyetja udhëheqëse	Intervistat pasuese	

Edhe efektet e padëshiruara ose të përkundërta duhen mënjanuar (p.sh planifikim i TiT mund të vështirësohet duke aplikuar Kurrikulën Globale). Përmbajtja e Kurrikulës globALE dhe mënyrës së ofrimit të saj do të shqyrtohen me pjesëmarrësit në mënyrë që të merren sa më shumë të dhëna për draftin përfundimtar.

Mirënjohje

Autorët e Kurrikulës Globale duan të shprehin mirënjohjen e veçantë për Levan Kvatchadze i cili ishte përfshi thellë në ngritjen e projektit dhe analizën paraprake të koncepteve ekzistuese, PD Dr. Markus Hoffer-Mehlmer, i cili zhvilloi konceptin e detajuar të trajnimit. Gjithashtu, duan të falënderojnë Bianka Spieß nga Layout Manufaktur në Berlin, Gjermani dhe Garegin Martirosian nga The Sign në Jerevan, Armeni për mbështetjen e tyre në zhvillimin e logotipit për Kurrikulën globALE.

Kurrikula Globale është diskutuar me grupin e punës të Volkshochschulen gjerman për ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e cilësisë, dhe këshillimin, çka ofroi reflektime të frytshme mbi strukturën dhe qëllimin e iniciativës. Kontribute të vlefshme erdhën edhe nga ekspertët që morën pjesë në punëtorinë më 3 dhjetor dhe 4 2012.¹⁵

Kurrikula Globale është diskutuar me grupin e punës të Volkshochschulen gjerman për ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e cilësisë, dhe këshillimin, çka ofroi reflektime të frytshme mbi strukturën dhe qëllimin e iniciativës. Kontribute të vlefshme erdhën edhe nga ekspertët që morën pjesë në punëtorinë më 3 dhjetor dhe 4 2012.

Ekipi don të falënderojë thellësisht të gjithë që u përfshinë në zhvillimin e Kurrikulës Globale si përpjekje të përbashkët.

Kurrikula Globale është e hapur për çdo reagim e koment. Nëse jeni të interesuar për ta zbatuar kurrikulën ose të përfshihen në zhvillimin e mëtejshëm të saj, ju lutemi kontaktoni me një anëtar të ekipit (lista e anëtarëve të ekipit me të dhënat e kontaktit mund të gjenden nën www.curriculum-globale.de).

15 Ekspertët pjesëmarrës ishin: Emir Avdagic, DVV International, Bosnje-Hercegovina; Maja Avramovska Trpevska, DVV International, Maqedoni; Prof. John Jacques William Aitchison, Universiteti KwaZulu-Natal, Afrikë e Jugut; Anita Borkar, ASPBAE, Indi; Dr. Kailash Choudhari, IAEA, Indi; Tania Czerwinski, DVV International, Gjermani; Filip Dedeurwaerder-Haas, Landesverband der Volkshochschulen von Nordrhein-Westfalen, Gjermani; Dr. Martha Farrell, PRIA, Indi; Dr. Marion Fleige, Technische Universität Chemnitz, Gjermani; PD Dr. Markus Höffer-Mehlmer, Johannes Gutenberg-Universität Mainz, Gjermani; Prof. Dr. Wolfgang Jütte, Universität Bielefeld, Gjermani; Susanne Lattke, DIE, Gjermani; Prof. Dr. Henning Pätzold, Universität Koblenz-Landau, Gjermani; Dr. Katarina Popovic, Universiteti i Beogradit, Serbi; Angel Marcelo Ramirez Eras, Guanchuro, Ecuador; Prof. Dr. Michael Schlemmann, Justus-Liebig-Universität Gießen, Gjermani; Dr. Beate Schmidt-Behlau, DVV International, Gjermani; Prof. Syed Yusuf Shah, IAEA, Indi; Maduh Singh, UIL, Gjermani; Galina Veramejchyk, DVV International, Bjellorusi; Jesco Weickert, DVV International, Gjermani; Fatima Yacine, Direction de la Lutte Contre l'Analphabétisme, Marok

Literatura

- CEDEFOP (2013): Trainers in continuing VET: emerging competence profile. Luxembourg: *Publications Office of the European Union*
- Council of the European Union: Council Resolution on a renewed European agenda for adult learning. In: *Official Journal of the European Union C 372 of 20.12.2011*
- European Commission: Communication from the Commission: Adult learning: It is never too late to learn. Brussels, 23.10.2006. COM(2006) 614 final
- European Commission: Communication from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions: Action Plan on Adult learning. It is always a good time to learn. Brussel, 27.09.07. COM(2007) 558 final
- European Parliament/Council of the European Union: Recommendation of the European Parliament and of the Council of 23 April 2008 on the establishment of the European Qualifications Framework for Lifelong Learning. In: *Official Journal of the European Union C 111 of 06.05.2008*
- OECD: The definition and selection of key competencies. Executive summary. Online: <http://www.oecd.org/dataoecd/47/61/35070367.pdf>, 2005 (Qasje e fundit: 04.08.12)
- UNESCO: Harnessing the power and potential of adult learning and education for a viable future. Belém Framework for Action. CONFINTEA VI. Belém, 4 December 2009
- UNESCO Institute for Lifelong Learning (UIL): *Global Report on Adult Learning and Education. Hamburg 2009*
- UNESCO Institute for Statistics (UIS) (2012). *International Standard Classification of Education, ISCED 2011*. Montreal: UNESCO Institute for Statistics

Moduli 0: Hyrje

Qëllimi

Qëllimi i kësaj njësie hyrëse është t'i njohë pjesëmarrësit me Kurrikulën globALE dhe të vërë një themel të fortë për përfundimin e suksesshëm të trajnimit që i pret. Kjo përfshin disa dimensione:

- Së pari, pjesëmarrësit pajisen me të gjitha informatat relevante lidhur me kurrikulën, duke përfshirë qëllimet e përgjithshme dhe filozofinë e kurrikulës si dhe detajet praktike lidhur me përfundimin e kursit të trajnimit.
- Së dyti, pjesëmarrësit nga ana e vet ftohen të ndajnë informacion mbi sfondin individual (profesional) si dhe nevojat e pritshmëritë ndaj trajnimit me ofruesin e trajnimit në mënyrë që të mundësohet përshtatja e duhur e kursit të trajnimit.
- Së treti, kjo njësi hyrëse duhet të sigurojë pjesëmarrësve dhe lehtësuesve mundësinë për të hyrë në kontakt me njëritjetrin, për të shkëmbyer informacion dhe për të ndërtuar një marrëdhënie personale me qëllim të krijimit të një mjedisi konstruktiv të të nxënit.

Formati

Idealisht, kjo njësi hyrëse do të bëhet si takim sy më sy - që zgjat të paktën një ditë të plotë - të pjesëmarrësve dhe lehtësuesve. Është e mundur me përdorë material të shtypur dhe/ose online për sigurimin e informacionit të nevojshëm mbi kurrikulën, dhe me përdorë e-mail dhe/ose një forum interneti për shkëmbim dhe diskutim ndërmjet pjesëmarrësve dhe trajnuesve/lehtësuesve. Megjithatë, duke marrë parasysh se qëllimi i këtij moduli është të ndërtojë marrëdhënie personale aq sa ka të bëjë me dhënien e informacionit, rekomandohet të mundësohet, kudo që të jetë e mundur, një takim fizik i të gjithë aktorëve të përfshirë në fillim të trajnimit, para angazhimit në modulet e mëposhtme tematike. Sido që të jetë, është e rëndësishë së veçantë që komunikimi në këtë modul të jetë i shumanshëm dhe që, përveç shkëmbimit të informativ faktike, trajnerët/lehtësuesit dhe pjesëmarrësit të kenë mundësi të artikulojnë pritshmëritë e tyre dhe kërkesat prej trajnimeve.

Përmbajtja

Përmbajtja që do të mbulohet nga ky modul hyrës përfshin:

Informacion mbi Kurrikulën globALE

- Informata të përgjithshme mbi Kurrikulën globALE, filozofinë dhe parimet e saj
- Qëllimin e Kurrikulës
- Objektivat e nxënies dhe kompetencat për t'u fituar
- Prezentim i përgjithshëm i moduleve individuale

Informacion mbi trajnimin

- Struktura e trajnimit
- Formatet e trajnimit
- Aktivitetet e nxënies dhe metodat e parapara
- Mënyrat dhe kanalet e komunikimit
- Oraret
- Vendet për fazat e vijimit

Informacion mbi ofruesin e trajnimit

- Informata personale për trajnerët/lehtësuesit: përgatitja profesionale dhe përvoja në Mësimin e të Rriturve
- Detajet e kontaktit të trajnerëve/lehtësuesve
- Detajet e kontaktit të personelit administrativ dhe përkrahës

Informacion mbi pjesëmarrësit dhe pritshmëritë e tyre

- Informata personale për pjesëmarrësit: përgatitja profesionale dhe përvoja paraprake me MRr
- Nevojat dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve

Pritshmëritë e Kurrikulës globALE nga pjesëmarrësit

- Kërkesa për zotim të nxënies aktive
- Kërkesa për reflektim dhe zbatim praktik të përmbytjes së programit

Ndërtimi i marrëdhënieve

- Njohja me njëri-tjetrin
- Shkëmbimi detajeve të kontaktit për komunikim të mëtejshëm mes pjesëmarrësve dhe trajnerëve/lehtësuesve

Vijimi: Jetësimi i pritshmërive

Informatat e paraqitura në këtë modul fillestar mbi pritshmëritë dhe përgatitjet e pjesëmarrësve duhen përdorë si bazë për formësimin e rrjedhës së mëtejme të kontekstit individual. Formësimi ka mundësi të ndodhë në dy drejtime kryesore:

- Përzgjedhja e temës për pesë modulet bazë tematike mund të përshtatet me përgatitjen paraprake të pjesëmarrësve, pra duke zgjedhë shembuj nga fusha në të cilat janë aktivë pjesëmarrësit (si: shkrim-lexim, demokraci, arsim, fuqizim i bashkësisë)
- Pritshmëritë që artikulojnë pjesëmarrësit mund të përdoren për t'i përkufizuar temat e moduleve zgjedhore. Këto module mund të konceptualizohen në mënyrë të lirshme sa kohë që plotësohen dofarë kriteresh shtesë. Prandaj modulet zgjedhore mund të përdoren sa më shumë – brenda kufijve të resurseve të disponueshme – për të formuar trajnime të formësuara sipas nevojave individuale.

Mënyra e tretë për ta përshtatë trajnimin mund të parashikohet në parim: Pjesëmarrësit që tashmë posedojnë një pjesë të rëndësishme kompetencash të fituara me anë të Kurrikulës globALE mund të përjashtohen nga pjesë përkatëse të trajnimit ose edhe të përfshihen si bashkëtrajnues. Megjithatë, kjo kërkon përdorim të procedurave të përshtatshme RPL. Meqë mekanizma të tillë RPL ende nuk janë konsoliduar, kjo për momentin mund të jetë një opsion realist vetëm në disa raste. Kjo megjithatë mund të ndryshojë perspektivën afatmesme, pasi disa mjete RPL për edukatorët e të rriturve janë tashmë në dispozicion dhe mund të përshtaten për qëllime të Kurrikulës globALE.

Moduli 1: Qasja te Arsimit i të Rriturve

Kompetenca¹⁶

Individualët që kanë mbaruar Kurrikulën globALE dinë dhe kuptojnë funksionet dhe veçantitë e fushës së arsimit të të rriturve si dhe rëndësinë saj në kontekstin e tyre social, po edhe krahasuar me kontekste t: e mundshme dhe në dritën e një rrjeti më të gjerë ndërkombëtar. Janë në gjendje të pozicionojnë rolin e tyre profesional brenda këtij konteksti.

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE

- janë të vetëdijshëm se praktika e arsimit të të rriturve formësohet nga pikëpamje të ndryshme të njerëzimit dhe t'kuptuarit e ndryshëm të arsimit, çka i çon ata tek nxënia e kuptimeve themelore të mësimit për të rritur dhe etikës së tij;
- Kuptojnë diversitetin e arsimit të të rriturve dhe se ai pozicionohet në kulturë; familjarizohen me forma të ndryshme të arsimit të të rriturve në vendin e tyre dhe i dinë kuptimet e konotacionet e temave kyç që përdoren rëndom për t'iu referuar formave të ndryshme të arsimit të të rriturve;
- kanë kuptim themelor të zhvillimeve ndërkombëtare që janë relevante për kontekstin e tyre për arsimin e të rriturve;
- mund të pozicionojnë kontekstin e tyre të arsimit të të rriturve brenda diversitetit ekzistues të arsimit të të rriturve;
- mund të pozicionojnë rolin e tyre si arsimues i të rriturve brenda këtij konteksti;
- janë të familjarizuar me dispozita të rëndësishme të kornizës ligjore që janë relevante për arsimin e të rriturve në vendin e tyre, rajonin dhe nivelin ndërkombëtar;
- arrijnë të dallojnë, kategorizojnë dhe shpjegojnë format komplekse të financimit në arsimin e të rriturve;
- janë të familjarizuar me tiparet themelore të politikës aktuale relevante për arsimin e të rriturve;
- dinë për aktorët më të rëndësishëm që janë relevantë për arsimin e të rriturve në rajonin e tyre, shtetin, dhe, nëse është relevante, në nivelin ndërkombëtar;
- mund të reflektojnë në mënyrë kritike mbi funksionet dhe interesat e aktorëve individualë që shoqërohen me arsimin e të rriturve, si dhe marrëdhëniet ekzistuese të pushtetit.

Lidhjet me modulet e tjera

Qëllimi qendror i këtij moduli është të zhvillojë të kuptuarit kritik të gjithë konceptit të mësimit dhe arsimit të të rriturve si dhe të nocioneve e aspekteve bazë që lidhen me arsimin e të rriturve. Në këtë kuptim moduli ofron bazë dhe ka lidhje me të gjitha modulet e tjera. Gjendja e arsimit të të rriturve brenda një kulture, që është nocioni kyç në këtë modul, duhet të pasqyrohet në modulet e tjera, p.sh. kur mësohen dhe testohen metoda të caktuara për mësimdhënie (moduli 4) ose vlerësim (moduli 5) ose gjatë shqyrtimit të teorive të ndryshme të të nxënimit (moduli 2) ose perceptimeve të komunikimit dhe të dinamikave grupore (moduli 3). Po ashtu, çështja e motivimit dhe pjesëmarrjes në të nxënimit e të rriturve (moduli 2) lidhet ngusht me mënyrën se si arsimit i të rriturve është vendosur në një kontekst të dhënë.

Roli i një edukatori të të rriturve, qëndrimi i tij profesional dhe vlerat që prezantohen si temë në këtë modul definitivisht duhet të merren parapë kur merremi me parimet e nxënies dhe të aktivitetit didaktik (moduli 2). Inkurajohet prandaj ndërthurja sa më e madhe e këtyre dy moduleve.

Temat

Të kuptuarit e varietetit dhe diversitetit të arsimit të të rriturve

- Parimet e pedagogjisë/andragogjisë:
 - supozimet themelore antropologjike, konceptimi i njeriut, arsimit, socializimi
 - Teoritë e arsimit, koncepti i arsimit, mësimit i të rriturve
 - Etika e arsimit të të rriturve

¹⁶ Përshkrimi i kompetencës së këtij moduli nuk i referohet mundësisë për të vepruar në kuptim të ngushtë por një grupi themelor njohurish dhe qëndrimesh ashtu që me përgjegjësi të kryhen kompetencat e përshkuara në modulet pasuese.

- Të kuptuarit e fushës: Çka d.m.th. “arsimi i të rriturve” dhe çka përfshin?
 - Përkufizim nga të gjitha fushat e arsimit
 - Arsimi i të rriturve dhe mësimi tërëjetësor
 - Konceptet teorike dhe kufizimet aktuale të arsimit të të rriturve
 - Të kuptuarit e koncepteve kyç (p.sh.. arsimi formal, joformal, të nxënës informal, etj.)
 - Fusha të ndryshme praktike: p.sh. trajnimi profesional, arsimimi në komunitet
- Roli i kontekstit socio-historik
 - vendosja kulturore e mësimi dhe arsimit të të rriturve
- Funksionet dhe përfitimet e arsimit të të rriturve
 - Pse arsimi i të rriturve?
 - Interesat sa i përket arsimit të të rriturve
 - + Nxënësit
 - + Shoqëria
 - + Ekonomia
 - + Strukturat shtetërore (komunale, rajonale, kombëtare)
 - + Sektori i arsimit
 - Përfitimet e arsimit të të rriturve
 - + personal
 - + social
 - + ekonomik
 - + global
 - Aspektet gjinore të arsimit të të rriturve
- Roli i inkurajimit të pjesëmarrjes në arsimin e të rriturve
- kufijtë dhe mundësitë e arsimit të të rriturve
- Marrëdhëniet e pushtetit në fushën e arsimit të të rriturve
- Arsimi i të rriturve si disiplinë akademike

Arsimi i të rriturve në kontekstin kombëtar e global

- Zhvillimet kombëtare e ndërkombëtare në arsimin e të rriturve
- Tiparet kyçe të politikës së arsimit të të rriturve
- Sfidat kombëtare: Në ç’kontekst gjithëpërfshirës zë vend arsimi i të rriturve?
- Kryeaktorët e fushës
 - Lokalë
 - Shtetërorë
 - Ndërkombëtarë
 - Tregu i arsimit të të rriturve – reliefi ofruar dhe ana e kërkesës
 - Grupet e synuara
- Kushtet e kornizës kombëtare
 - Rregulloret statutoare
 - Financimi i arsimit të të rriturve
 - Të dhënat statistikore kornizë (pjesëmarrja në arsimin e vazhdueshëm, etj.)

Arsimi i të rriturve si profesion dhe roli i një edukatori të të rriturve në kuptimin e Kurrikulës globale

- Tipare të veçanta të arsimit të të rriturve si profesion
- Shtigjet e karrierës në arsimin e të rriturve – hyrja dhe mundësitë e zhvillimit
- Të drejtat dhe detyrimet si një edukator i të rriturve– kushtet e kornizës ligjore
- Reflektime mbi rolin vetjak
 - Perspektiva biografike: Pse dua të punoj në arsimin e të rriturve?
 - Perspektiva etike, qëndrimi, përgjegjësia (ndikimi i veprimeve vetjake)
- Kompetenca personale: parimet e menaxhimit të kohës dhe të vetëmenaxhimit, vetëmarketimi
- Puna e orientuar shkencërisht: interpretimi i rezultateve të studimit, statistikave, etj.

Literatura e sugjeruar (përzgjedhje)

- Freire, Paulo. *Pedagogy of the Oppressed*. New York, 2007
- Elias, John L.; Merriam, Sharran B.: *Philosophical Foundations of Adult Education*, Malabar, 1995
- World Education Forum, Dakar, Senegal. 2000. *The Dakar Framework for Action*. Education for All: Meeting our Collective Commitments. Paris, UNESCO.

Shënime mbi zbatimin

Mbasi arsimit të rriturve formësohet thellësisht nga konteksti social në të cilin është rrënjësorë, ky modul duhet të kontekstualizohet edhe më tej sesa modulet e tjera. Rekomandohet fuqimisht që përvoja paraprake e pjesëmarrësve të merret si pikënisje dhe të fokusohet përmbajtja e modulit rreth arsimit specifik të të rriturve në vendin/rajonin e tyre. Temat dhe pyetjet e listuara më sipër ofrojnë një kuadër çështjesh që mundën dhe duhen të merren parasysh në këtë modul. Nuk është e domosdoshme as nuk rekomandohet që të merret secila temë veç e veç. Më parë, trajnerët dhe pjesëmarrësit inkurajohen t'i zgjedhin ato tema që kanë rëndësinë më të madhe për ta në thellësi më të madhe. Për t'u vetëdijësuar rreth veçantive të një konteksti të caktuar (p.sh. atij vetjak), duhet pasur aftësi krahasimi dhe me i pa kontekstet e tjera e ato alternative po ashtu. Prandaj, ndërkohë që kontekstualizimi është tipar më rëndësor në këtë modul dhe duhet të ofrojë bazën e përgjithshme, prapëseprap rekomandohet që të hapet një perspektivë më të gjerë kohë pas kohe dhe të bëhen krahasime. Aty ku është e përshtatshme, ndërmjet realiteteve specifike të arsimit të të rriturve të pjesëmarrësve dhe realiteteve të tjera të arsimit të të rriturve. P.sh. arsimit i të rriturve mendohet t'u shërbejë qëllimeve të ndryshme sipas pikëpamjes. Fokusi mund të jetë p.sh. në zhvillimin e aftësive profesionale për tregun e punës ose për promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të kohezionit social ose për fuqizimin e individëve dhe të bashkësive për t'i marrë vendimet në duart e veta. Nëse përvoja e pjesëmarrësve formësohet kryesisht nga një qëllim i vetëm, ky modul do të duhej t'u mundësonte që të vetëdijësohen edhe për qëllime të tjera që mund të jenë shpesh të asociuara me arsimin e të rriturve.

Rendi me të cilin temat e këtij moduli listohen nuk duhet të shihet si parashkrim sa i përket zbatimit. Metodologjikisht mund të jetë e dobishme të fillohet me nocionin dhe rolin e një "edukatori të të rriturve" dhe të lidhet kjo me perspektivën biografike të pjesëmarrësve, para se të eksplorojnë më në thellësi veçoritë e fushës. Arritja e një ekuilibri me njohuri abstrakte analitike dhe perspektivë individuale duhet të jetë komponenti kyç gjatë gjithë këtij moduli. Prandaj, inkurajohet fuqimisht të përfitohet nga përvoja personale e pjesëmarrësve sa më shumë.

Zbatim praktik dhe reflektim

Element qendror në këtë modul është si të prezentohet fillimisht baza dhe parimet e arsimit të të rriturve, edhe tematikisht po edhe në raport me përvojat e pjesëmarrësve. Meqë një pjesë e këtij elementi përbëhet nga njohuritë paraprake, mjetet e përshtatshme përfshijnë metodat e prezantimit, studimin vetjak dhe punën në grup. Vizitat e projektit mund të përfaqësojnë shtesë të dobishme sidomos nëse qëllimi është të fuqizohet lidhja me një institucion. Një sfidë e veçantë është ndërlidhja e elementeve strukturore ose gjetjeve shkencore me situatën personale të pjesëmarrësve përkatës dhe rolin të tyre si edukatorë të të rriturve në kontekst të caktuar të arsimit të të rriturve. Marrëdhëniet e tilla mund të gjenerohen nëpërmjet një pune të vogël grupore ose metodave kreative si de nëpërmjet detyrave për reflektim individual. Reflektimi rreth kontekstit vetjak të punës si një edukator i të rriturve kundër një sfondi të një njohurie më të gjerë e më të përgjithshme për arsimin e të rriturve duhet të jetë element thelbësor i këtij moduli

Fushëveprimi i rekomanduar:

- 32 orë udhëzime (≈4 ditë)
- 32 orë studimi dhe vlerësimi individual

Zbatim praktik dhe ushtrime, p.sh. vizita projekti

- e ndryshueshme (ndërmjet 25 e 120 orë) sit ë jetë e përshtatshme

Moduli 2: Mësimdhënia dhe mësimnxënia e të rriturve

Kompetenca:

Individët që kanë kryer Kurrikulën globALE kanë njohuri të teorisë së të nxënës dhe mund të lidhin këtë me aktivitetin e tyre didaktik. Ata njohin veçoritë motivuese, psikologjike dhe sociale të mësimin të të rriturve dhe t'i marrin ato parasysh në planifikimin dhe zbatimin e mësimin të tyre

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE

- njohin tiparet kyç të mësimin të të rriturve kundrejt nxënës në shkollë;
- mund të dallojnë arsyet individuale për të filluar proceset e të nxënës dhe janë në gjendje të shtojnë motivimin e të nxënës;
- dinë t'i identifikojnë barrierat e të nxënës dhe – sa më shumë që është realisht mundën – t'i zvogëlojnë;
- janë të njohur me modele relevante psikologjike dhe implikimet e tyre për procesin e nxënës;
- mund të përdorin këto përmasa të ndryshme të ndryshme të punës së tyre me të rritur si për planifikim ashtu edhe për ndërveprim direkt për ta arritur suksesin e qëndrueshëm të të nxënës.

Lidhjet me modulet e tjera

Ky modul fokusohet në teoritë e të nxënës dhe jep njohuri për vetë procesin e të nxënës. Prandaj lidhet shumë me teoritë për arsimin e të rriturve, perceptimin dhe funksionimin e arsimit të të rriturve dhe të nxënës në kontekst (moduli 1). Në të njëjtën kohë, është bazë me rëndësi për zbatimin e metodave të ndryshme në mësimdhënien për të rritur (moduli 4) dhe për komunikimin me lloje të ndryshme pjesëmarrësish (moduli 3). Parimet didaktike sidomos lidhen me përdorimin e metodave (moduli 4), por lidhen edhe me qëndrimin profesional të edukatorëve të të rriturve dhe rolin e tyre (moduli 2 e moduli 5).

Temat

Teoritë dhe arsyet e të nxënës:

- Ç'është të nxënës?
- Parimet e teorisë të ndryshme të të nxënës dhe arsyet në arsimin e të rriturve, p.sh.:
 - Teoria konstruktiviste e të nxënës
 - Teoria shkencore e të nxënës
 - Teoria fenomenologjike e të nxënës
 - Të nxënës transformativ
 - Behaviorizmi
 - Teoritë neuro-shkencore të të nxënës
- Marrëdhënia nxënës-mësues në teori të ndryshme të mësimin të të rriturve
- Andragogjia si shkencë e arsimit dhe nxënës së të rriturve

Aktiviteti didaktik në arsimin e të rriturve

- Efektet e teorisë të ndryshme dhe arsyet e të nxënës sa u përket aktiviteteve didaktike
- Parimet didaktike të arsimit të të rriturve
 - Orientimi kah pjesëmarrësit
 - Orientimi kah përvoja
 - Marrëdhënia me mjedisin jetësor

Format e njohurive

- Njohuria kristaline kundrejt të rrjedhshmes
- Njohuria deklarative kundrejt procedurales

Nxënia e të rriturve

- Si mësojnë të rriturit?
- Dallimet në aftësinë për të mësuar në mosha të ndryshme
- Llojet e të nxënit:
 - Të nxënit kognitiv
 - Të nxënit emocional
 - Të nxënit në bazë sjelljeje
 - Të nxënit nga përvoja
- Format e të nxënit tradicional në kontekstin vetjak kulturor
- Përballja e situatave të të nxënit si sfida

Motivimi arsimor

- Arsyet për fillimin e proceseve arsimore
 - Përmasat psikologjike
 - Përbërësit e lidhur me grupin
 - Përbërësit socio-demografikë
 - Arsyet për mungesë e braktisje arsimit
 - Faktorë të jashtëm dhe pjesëmarrje në arsim/barriera për pjesëmarrje
 - + Faktorët/milieu socio-demografikë
 - + Kushtet kornizë
 - Kostot
 - Koha
 - Lokacioni
 - Kohëzgjatja
 - Semestri
 - Përbërësit specifikë gjinorë

Faktorët e mëposhtëm janë të një rëndësie qendrore që arsimuesit e të rriturve të fitojnë kompetencat përkatëse:

- Referenca për mjedisin përkatës kulturor individual
- Zbërthimi i informacionit të shpërndarë në kontekstin specifik të veprimtarisë
- Shtimi ose mungimi i dimensioneve jorelevante sipas nevojës

Literatura e sugjeruar (përzgjedhje)

- Bélanger, Paul: *Theories in Adult Learning and Education*. Opladen & Farmington Hills 2011
- Jarvis, Peter: *Lifelong Learning and the Learning Society*, New York 2007
- Mezirow, Jack (Ed.): *Learning as Transformation: Critical Perspectives on a Theory in Progress*. San Francisco 2000
- Pätzold, Henning: *Learning and Teaching in Adult Education, Contemporary Theories*, Opladen 2011

Shënime mbi zbatimin

Meqë arsimimi i të rriturve është portretizuar në bazë të teorive shkencore, rëndësia e nevojshme për dizajn të kursit individual duhet të krijohet me anë të përgatitjes adekuate didaktike. Pas përdorimit të metodave për të shpërndarë informacionin, si prezentimet me ekran ose udhëzimet interaktive, kjo d.m.th. mundësim vetë-përvojë përmes roleve dhe simulimeve si dhe duke theksuar implikimet për aktivitetin mësimor të vetë pjesëmarrësve përmes punës në grupe dhe detyrave individuale. Edhe përvojat nga puna e projektit mund të reflektohen.

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE duhet të reflektojnë se cilat attribute të veçanta i kanë pjesëmarrësit e tyre dhe si mund të përdoret kjo në mënyrë efektive në aktivitetin e tyre didaktik. Për më tej, duhet të motivohen ta vazhdojnë mësimin vetë - në një mjedis formal ose joformal.

Zbatimi praktik dhe reflektimi

Pjesa teorike e modulit sfidon qasjen interaktive të trajnerit. Kjo mund të prezentohet duke përdorë situata të ndryshme të të mësuarit, që mund të ilustrojnë teori të ndryshme të të nxënit. Përvojat nga jeta dhe puna e pjesëmarrësve mund të merren si shembuj të mirë për përshkrimin e fazave të mësimin në bazë të teorive të ndryshme. Në të njëjtën kohë, vetë procesi i tyre të nxënit dhe motivimi për të marrë pjesë në kurs mund të diskutohen si një hyrje dhe/ose material për tema të veçanta. Nëpërmjet punës në grupe, mund të analizohen motivimi për pjesëmarrja kundrejt barrierave për të nxënë, dhe të sugjerohet e të konsiderohet një lloj adekuat i qasjes së të nxënit. Pjesëmarrësit mund të përqendrohen në kontekstin e tyre lokal dhe të diskutojnë tema të veçanta nga kjo pikëpamje (p.sh. kushtet kornizë, aktivitetin e përshtatshëm didaktik, etj).

Fushëveprimi i rekomanduar

- 32 orë udhëzime (≈4 ditë)
- 32 orë studimi dhe vlerësimi individual

Zbatim praktik dhe ushtrime:

- e ndryshueshme (ndërmjet 25 dhe 120 orë) sipas nevojës

Moduli 3: Komunikimi dhe dinamika grupore në Arsimin e të Rriturve

Kompetenca

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE janë të njohur me parimet teorike të komunikimit dhe janë në gjendje t'i aplikojnë ato në mësimdhënie si dhe në punën e tyre arsimore me të rriturit. Ata janë të njohur edhe me teoritë kryesore të dinamikës grupore dhe janë në gjendje ta aplikojnë këtë në veprimtarinë e mësimdhënies/ nxënies në grup në mënyrë që të drejtojnë proceset shoqërore.

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE

- janë të njohur me rregullat e komunikimit verbal, si dhe të komunikimit paraverbal e joverbal dhe zbatojnë këtë njohuri kur kanë të bëjnë me pjesëmarrësit e kursit;
- janë në gjendje të aplikojnë komponentët individuale të komunikimit interaktiv, konstruktiv e motivues
- janë në gjendje të eliminojnë ose zbusin barrierat dhe pengesat në komunikim;
- krijojnë një atmosferë pozitive me stilin e tyre të komunikimit;
- mund të merren me stile të ndryshme të komunikimit dhe të udhëzojnë pjesëmarrësit në kontekst të proceseve të orës mësimore dhe të mësimdhënies;
- janë në gjendje të perceptojnë strukturën e “padukshme” dhe të komunikojnë në grup; e njohin, kuptojnë, moderojnë dhe drejtojnë proceset e dinamikës grupore për të siguruar suksesin e qëndrueshëm të të nxënës;
- përshtatin fazat e proceseve të të nxënës dhe fazat e dinamikës grupore me njëri-tjetrin
- janë në gjendje të merren me sukses me situatat problematike në grup; janë në gjendje të merren me situata konflikti dhe me pjesëmarrësit e “vështirë”
- janë të vetëdijshëm për rëndësinë e emocionalitetit për mësimin e të rriturve

Lidhjet me modulet e tjera

Ky modul lidhet ngusht me metodat (Moduli 4), sidomos meqë është baza për përdorimin e shumë metodave - duke i ditur parimet e komunikimit të mirë dhe të kryesimit të grupit, do të jetë e mundshme që pjesëmarrësit të zbatojnë edhe ato metoda që nuk ishin shpjeguar a praktikuar detajisht gjatë kursit, ose disa metoda të reja për të cilat kanë lexuar. Njëkohësisht, ky modul ndërlidhet me modulet 1 e 2, veçmas lidhur me mënyrat se si të rriturit mësojnë, karakteristikat specifike, kontekstin dhe motivimin. Këto pikëpamje janë pikërisht metodat e komunikimit që duhet të përdoren për t'iu qasur të rriturve. Për më tej, komunikimi adekuat dhe një atmosferë e mirë në grupin e punës janë faktorët më të rëndësishëm motivues dhe pengesat më të forta për nxënien e të rriturve, nëse nuk janë të përshtatshme dhe pozitive. Prandaj, përgjatë këtij moduli, disa përgjigje praktike duhet t'u jepen pyetjeve më të përgjithshme të të nxënës ndër të rriturit, dhe disa ilustrime konkrete të aspekteve të vetme të teorive të të nxënës ndër të rritur, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet mes mësuesit dhe nxënësit të rritur.

Temat

Komunikimi në arsimin e të rriturve

- Termit e komunikimit, modelet e komunikimit dhe parimet e teorive të komunikimit
- Teoritë e arsimit të të rriturve dhe konceptet e tyre të komunikimit
- Elementet themelore dhe tiparet kryesore të komunikimit
- Llojet dhe nivelet e komunikimit
 - të dukshme - informative
 - të padukshme - niveli emocional i komunikimit
 - komunikimi verbal, joverbal dhe paraverbal
- Parimet e komunikimit (respektues, motivues, i ndërsjellë, etj.)
- Përbërësit dhe teknikat e komunikimit (të dëgjuarit aktiv, nivelet e komunikimit, shmangia e vrasjeve të diskutimit, bërja e pyetjeve)
- Dhënia e informatave kthyesë, shprehja dhe pranimi i kritikave, veçanërisht në kontekstin e arsimit
- Komunikimi grupor dhe individual
- komunikimi i padhunshëm dhe siguroes; komunikimi përkrahës dhe fuqizues
- Ballafaqimi me stile të ndryshme të komunikimit në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies
- Njohja dhe eliminimi i pengesave të komunikimit në mësim dhe proceset e të nxënit
- Aspekte dhe teknika të udhëzimeve në lidhje me komunikimin në orë mësimi dhe proceset e të nxënit
- Komunikimi ndërkulturor, duke marrë parasysh specifikat kulturore në komunikim
- Mediat sociale dhe komunikimi digjital
- Gjuha e përshtatshme gjinore dhe komunikimi me ndjeshmëri gjinore
- Elementet specifike që ndikojnë në komunikimin:
 - gjinia
 - diversiteti
 - qëndrueshmëria
 - kultura
 - konteksti
- Bazat e komunikimit të brendshëm
- Bazat e komunikimit të jashtëm (PR, marketing)

Dinamika grupore në arsimin e të rriturve

- Rëndësia e dinamikës grupore për proceset e mësimdhënies dhe nxënies
- Parimet teorike të dinamikës grupore
- Format dhe karakteristikat e grupeve të të nxënit
- Fazat e zhvillimit të grupeve (përmbajtja dhe niveli i marrëdhënies)
- Projektimi i kulturës grupore - Rolet, nën-grupet, hierarkitë, vlerat dhe rregullat
- Struktura e proceseve dinamike të grupit
- Modele për punën me grupe (p.sh. ndërveprimi rreth një teme, sociometria, etj)
- Parimet e punës, metodat dhe teknikat për proceset drejtuese të dinamikës në grup dhe ndërhyrjes në dinamikat e grupit
- Rolet e ndryshme të edukatorit të të rriturve në grup të mësimdhënies/nxënies (trajner, moderator, lehtësues i nxënies, lider, ndërmjetës, këshilltar, udhëheqës, etj.) dhe kompleksiteti i multitasking-ut
- Strategjitë e komunikimit për zgjidhjen e problemeve dhe të konflikteve, duke njohur konfliktet dhe duke qenë në gjendje me u përballë me to
- Metodatat dhe teknikat për përballjen me situatat e vështira dhe pjesëmarrësit problematikë

Literatura e sugjeruar (përzgjedhje)

- Connolly, Brid: *Adult learning in groups*. 1. publ. Maidenhead 2008
- *Intercultural Learning T-kit*, Council of Europe, Strasbourg Cedex 2000.
- Johnson, David Read; Emunah, Renée (eds.): *Current Approaches in Drama Therapy*, Springfield 2009

Shënime mbi zbatimin

Varieteti metodologjik shqyrtohet në këtë modul. Me përdorimin e metodave që shtrihen nga prezentimet e shkurta me PowerPoint (p.sh. kur paraqiten teoritë e komunikimit) e deri te diagramet dhe modelet grafike (të modeleve të komunikimit) deri te fotografitë, video incizimet dhe filmat e shkurtë, aspektet individuale të komunikimit mund të sqarohen dhe të paraqiten në mënyrë shembullore, edhe duke përdorë situata ose persona të njohur.

Edhe pse ky modul përmban një pjesë teorike, ajo duhet të ilustruhet dukshëm me shembuj konkretë. Këshillohet një shumëllojshmëri metodash dhe një qasje kreative. Është shumë e rëndësishme të krijohet një atmosferë të relaksuar dhe e besueshme, ku pjesëmarrësit mund të bashkëndajnë përvojat, të tregojnë historitë e tyre, të reflektojnë mbi stilin e tyre të komunikimit dhe përvojat me grupe të ndryshme, si dhe të jenë mjaft të hapura për të përdorë materiale, metoda dhe qasje të ndryshme.

Zbatimi praktik dhe reflektimi

Këshillohet puna me shembuj realë, përdorimi i moduleve të mëparshme, përvojave të pjesëmarrësve dhe çështjeve të kontekstit. Arsimuesit e të rriturve duhet t'i inkurajojnë pjesëmarrësit të reflektojnë mbi stilin e tyre të komunikimit dhe të nxjerrin shembuj nga jeta e vet dhe mjediset profesionale (mirëpritur një qasje vetëkritike). E rëndësishme është të fillohet procesi i reflektimit dhe komunikimi i mësimdhënësit të kursit me pjesëmarrësit duhet të shërbejë si shembull i mirë i asaj që duhet të diskutohet dhe të rekomandohet (veçmas lidhur me komunikimin jo të dhunshëm, joautoritar dhe konstruktiv). Rekomandohen ushtrimet e vogla dhe seancat e reflektimit në situata reale, luajtja e roleve, simulimeve dhe detyrat në grupe të vogla. Një qasje aktive ushtrimi ndërveprues duhet të zbatohet sa më shumë që të sigurojë mësim efektiv, zbatim të shkathtësive të fituara në kontekst të jetës e të punës, për të arritur rezultate afatgjata.

Përgjithësisht, duhen shqyrtuar shembuj të shumtë, veçmas nga jeta dhe përvoja profesionale të vetë pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit duhet të reflektojnë edhe mbi përvojat nga grupe të tjera. Situatat nga e kaluara dhe e tashmja në grupe të mësimdhënies/nxënies, si dhe proceset aktualisht në vazhdim mund të shqyrtohen dhe për to të reflektohet. Arsimuesit e të rriturve mbi të gjitha mund të shqyrtojnë sekuenca dhe shembuj nga përvojat e veta. Pra, një shumëllojshmëri metodash janë në dispozicion - ushtrime të vogla, detyra në grupe të vogla, ilustrime grafike, sekuenca të vogla sociometrike, fotografi dhe filma të shkurtër. Edhe metodat nga repertori i trajnimit të dinamikës grupore janë të përshtatshme: psikodrama, loja me role, dialogu i kontrolluar, lojëra të tilla si NASA, kompania e automjeteve, ndërtimi i kullave, etj., por edhe ushtrimet me të cilat krijohen situatat tipike grupore, të praktikuara ose të projektuara për të vetëdijësuar.

Fushëveprimi i rekomanduar

- 32 orë udhëzime (≈4 ditë)
- 32 orë studimi dhe vlerësimi individual

Zbatim praktik dhe ushtrime:

- e ndryshueshme (ndërmjet 25 dhe 120 orë) sipas nevojës

Moduli 4: Metodatat e arsimit të rritur

Kompetenca

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE janë të njohur me repertorin e metodave të edukimit të rritur dhe mund ta zbatojnë atë për të arritur sukses optimal të nxënies te grupin përkatës i synuar.

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE

- janë të njohur me një spektër të gjerë metodash të arsimit të rritur dhe janë në gjendje t'i përmendin avantazhet dhe disavantazhet, kufijtë dhe mundësitë e tyre;
- janë në gjendje të zgjedhin metoda të përshtatshme që të përshtatshme për situatën në të gjitha fazat e kursit;
- kanë aplikuar në mënyrë të pavarur një grup bazë metodash dhe kanë reflektuar mbi to;
- mund të përdorin metodat për të arritur suksesin e qëndrueshëm të nxënies të grupit të tyre përkatës të synuar.

Lidhjet me modulet e tjera

Ky modul është ideal për të praktikuar njohuritë dhe kompetencat e mësuara në modulet e tjera. Çdo temë mund të përdoret si material për të zbatuar, ilustruar, prezentuar ose analizuar përdorimin e metodave individuale. Temat nga të gjitha modulet e tjera mund të analizohet nga pikëpamja e përshtatshmërisë së ndonjë metode, e kombinuar me kritere të tjera (grupi i synuar, koha, burimet, etj.). P.sh. grupet mund të zgjedhin metodën më të mirë për t'i shpjeguar llojet e ndryshme të nxënies tek të rriturit (moduli 2), për të krahasuar përfitimet e arsimit të rritur (moduli 1), ose për të eksploruar mënyra për tejkalimin e problemeve të komunikimit brenda grupit (moduli 3). Modulet e tjera mund të tregojnë se çfarë metodash mund të përdoren për të punuar me tema individuale, ose me llojet e ndryshme të pjesëmarrësve, dhe në këtë modul, këto ide mund të jetësohen.

Temat

Integrimi i metodave në udhëzime

- Çka janë metodat?
- Cilat janë kriteret për zgjedhjen e metodave adekuate?

Vështrim i metodave

- Vështrim: tipologjitë për metodat
- Rëndësia dhe përparësitë për metodat ndërvepruese
- Përshtatshmëria e metodave ndaj gjinisë, moshës, kulturës dhe tipareve të tjera të grupit të synuar
- Metodatat hapëse
 - Thyesisit e akullit
 - Lojëra për t'u njohur mes vete
 - Pyetje rreth pritshmërive
- Metoda për përhapjen e informatave, njohurive dhe zhvillimin e përmbajtjes
 - Ligjeratë
 - Prezentime
 - + Teknika të folurit
 - + Udhëzime ndërvepruese
 - + Demonstrim
 - + PowerPoint
 - + Tabela-flip & vegla të ngjashme
 - Metoda grupore
 - + Metoda projekti, detyra grupore
 - + Rrathë të nxënies, metoda me katër kënde dhe të ngjashme
 - + Përzierje variacionesh: metoda 5x5, metoda sandviç
 - + Të nxënies bashkëpunues me kompjuter

- Të nxënit individual
 - + Studimi individual
 - + Ditari i të nxënit
 - + Teknika leximi
 - + Mësim i bazuar në kompjuter
 - + Vizita vrojtimi
 - + Metoda me përkrahë vetënxënien dhe kapjen e aftësive të vetënxënies
- Të nxënit social dhe nga përvoja
 - + Raunde diskutimesh
 - + Lojë rolesh, simulime
 - + Psikodrama
 - + Punëtori, kafeteria bota, hapësira e hapur
 - + Vizita në terren: nxënia nga konteksti lokal
 - + Punë projekti
 - + Zgjidhje problemesh
 - + Të nxënit biografik
 - + Metoda pjesëmarrëse
- Metoda kreative
 - + Stuhi mendimesh
 - + Vizualizime
 - + Skulptura
 - + Vallëzim
 - + Teatër
 - + Shkrim kreativ
- Teknika moderimi
 - Roli i moderatorit kundrejt atij të trajnerit, mësuesit ose përçuesit të njohurive
 - Rregullat e moderimit
 - Teknika të pyetjeve
 - Metoda moderimi
- Nxemje dhe metoda për ta shtuar përqendrimin
- Metoda për mbylljen e udhëzimeve
 - Sesione mbyllëse dhe metoda të përmbledhjes
 - Sigurimi i rezultateve
 - Informata kthyesë për udhëzimin
- Metoda e teknika të të nxënit të vetorganizuar

Faktorët e mëposhtëm kanë rëndësi qendrore që arsimuesit e të rriturve t'i fitojnë kompetencat përkatëse:

- aplikimi konkret i metodave në vetë kontekstin e pjesëmarrësve të aktivitetit;
- vetëdijësimi se nuk ka metodë të përsosur, por se zgjedhja gjithmonë rrjedh nga baraspesha mes grupit, kushteve kornizë, objektivave të të nxënit dhe instruktorit të kursit; dhe
- praktikimi i ndërrimit të shënjestruar të metodave në kuadër të dinamikës sociale në grup.

Për më tej, lidhur me grupin e synuar të vetë arsimuesve të të rriturve dhe fushës së aplikimit, metodat duhet të zhvillohen në mënyrë të shënjestruar në një fushë shtesë (p.sh. zhvillimi i komunitetit ose arsimimi i familjes).

Literatura e sugjeruar (përzgjedhje)

- Pretty, Jules N.; Guijt, Irene; Scoones, Ian; Thompson, John: *A Trainer's Guide for Participatory Learning and Action*, London 1995
- Society for Participatory Research in Asia (PRIA): *A Manual for Participatory Training Methodology in Development*, New Delhi 2011
- *Training Essentials, T-kit*, Council of Europe publishing, Strasbourg Cedex, 2002

Shënime mbi zbatimin

Meqë metodat nuk mund të mësohen thjesht teorikisht de më pare shpalosin efektet në praktikën e mësimdhënies, ky modul ofron një fokus në shkëmbim, përpjekje dhe reflektim. Inputi për këtë modul përqendrohet në paraqitjet për tema të veçanta të tilla si moderimi ose vlerësimi. Moduli duhet të përmbajë ushtrime të shumta që shoqërohen me reflektim dhe diskutim. Fokusi duhet të vihet te kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes për aplikimin e metodave individuale, si dhe mbi mundësitë dhe kufizimet e metodave individuale dhe kërkesat që vendosen mbi arsimuesit e të rriturve. Pasi përvojat e pjesëmarrësve të kenë dhënë fryte me sukses në aplikimin e metodave, një varg metodash të provuara dhe të sprovuara në kontekstin kulturor, mund të zhvillohen bashkërisht..

Në këtë modul fokusi është vendosur te metodat që janë përdorur gjatë kryerjes së kurseve/udhëzimeve të arsimit të të rriturve. Metodatat për planifikimin, organizimin e vlerësimin të kurseve/ udhëzimeve janë trajtuar detajisht në një modul (planifikimi, organizimi dhe vlerësimi).

Zbatimi praktik dhe reflektimi

Moduli mbi metodat është mundësi e mirë që pjesëmarrësit të praktikojnë aftësitë dhe t'i përmirësojnë ato përmes procesit të nxënies në praktikë. Përvoja e tyre mësimore mund të përdoret gjerësisht për këtë pjesë, duke kombinuar reflektimin me mënyrat e përmirësimit. Loja e roleve është metodë shumë e mirë si kornizë për praktikimin e metodave të tjera - ku pjesa e grupit mund të luajë grupin e synuar "të zakonshëm" - pjesëmarrësit në kurs, dhe një ose më shumë pjesëmarrës mund të përdorin dhe të praktikojnë metodën, si dhe ta ndajnë përvojën dhe mendimet për gjithë procesin me grupin. Është e mundshme që të përdorin edhe të njëjtën temë dhe të prezantojnë 2-3 qasje metodike dhe më pas t'i krahasojnë e t'i diskutojnë përparësitë dhe vështirësitë e metodave individuale dhe kriterëve më të mira për përdorimin e tyre.

Fushëveprimi i rekomanduar:

- 32 orë udhëzime (≈4 ditë)
- 32 orë studimi dhe vlerësimi individual

Zbatim praktik dhe ushtrime:

- e ndryshueshme (ndërmjet 25 dhe 120 orë) sipas nevojës
- rekomandohet: pjesëmarrësit përgatitin, japin mësim dhe reflektojnë mbi të paktën 3 mësimet të vetat (75 orë), vizita vëzhguese të mësimdhënies, reagime nga kolegët

Moduli 5: Planifikimi, organizimi dhe vlerësimi te Arsimit të Rriturve

Kompetenca

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE janë të vetëdijshëm se si fazat e planifikimit (duke përfshirë zhvillimin e kurrikulës), organizimi, kryerja dhe vlerësimi janë të lidhura me njëra-tjetrën në ciklin profesional të veprimtarisë së një arsimuesi të rriturve. Për fazat e planifikimit, organizimit dhe të vlerësimit, ata kanë njohuri të metodave të ndryshme dhe janë në gjendje t'i aplikojnë ato në mënyrë që përshtatet me situatën, si dhe të reflektojnë në mënyrë kritike mbi këtë. Me vështrim drejt veprimtarisë së tyre profesionale, arsimuesit e të rriturve përdorin përvojën që kanë fituar për t'i përmirësuar sistematikisht programet e veta.

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE

- janë të njohur me fazat e ciklit profesional të veprimtarisë së arsimuesve të rriturve dhe kuptojnë se si ato lidhen me njëra-tjetrën;
- dinë metoda dhe mjete të ndryshme për të:
 - identifikuar nevojat e arsimit dhe të trajnimit,
 - formuluar qëllimet e të nxënës të orientuara nga kompetencat për programet e arsimit,
 - krijuar një dizajn metodologjik-didaktik për proceset e mësimdhënies/ nxënies,
 - planifikuar mësimet që marrin parasysh kushtet kornizë përkatëse,
 - kontrolluar vazhdimisht progresin e të nxënës, vlerësuar atë me transparencë dhe bërë ndryshime në hartimin e mësimet mbi këtë bazë si të nevojshme,
 - siguruar rezultate;
- janë të vetëdijshëm për pasojat e metodave dhe mjeteve të ndryshme dhe mund të reflektojnë në mënyrë kritike për zgjedhjen dhe aplikimin e tyre;
- përdorin gjetjet nga rezultatet dhe vlerësimet e siguruar për të përmirësuar vazhdimisht punën e tyre;
- njohin bazat dhe elementet e ndryshme të sigurimit të cilësisë.

Lidhjet me modulet e tjera

Të gjitha modulet e mëparshme mund të shërbejnë si bazë për krijimin e një cikli të mirë trajnimi. Meqë bazohen në parimet, fazat dhe llojet e mësimet të rriturve (modulet 1 dhe 2), është e rëndësishme që të kihen në mend parime teorike kur zhvillohen fazat veç e veç, sidomos fazat 1 dhe 2 (vlerësimi dhe planifikimi i nevojave). Për fazat 3 dhe 4 (organizimi dhe zbatimi) kompetencat nga modulet 3 dhe 4 (komunikimi, dinamika e grupit dhe metodat) duhet të shqyrtohen në mënyrë shumë të detajuar.

Çështja e sigurimit të cilësisë lidhet ngusht me kontekstin e punës së arsimuesve të rriturve, kontekstin lokal dhe kombëtar, komunitetin, ofruesit dhe organizatën partnere.

Temat

Fazat e ciklit profesional të veprimtarisë së një arsimuesi të rriturve

- Qasja dhe cikli i projektit, në lidhje me arsimin e të rriturve
- 5 faza: vlerësimi i nevojave, planifikimi, organizimi, puna, vlerësimi
- Lidhjet mes fazave të veçanta dhe efektet e tyre

Vlerësimi i nevojave

- Edukimi /trajnimi/ aftësitë e vlerësimit të nevojave
- Vlerësimi i nevojave individuale
- Vlerësimi i nevojave organizative
- Vlerësimi i nevojave të komunitetit

Planifikimi

- Parimet e analizës së nevojave të arsimit, pasqyrë e mjeteve më të rëndësishme të analizës
- Zhvillimi i kurrikulës
 - Parimet e zhvillimit të kurrikulës të orientuar nga kompetencat (diferencimi midis koncepteve me bazë rezultati dhe atyre me bazë në njohuri)
 - Profilët e aktivitetit si bazë për zhvillimin e kurrikulës
- Përcaktimi i objektivave të mësimi (mësimi i taksonomive të objektivave, sistemet SMART e SPICE, etj.)
- Analizë grupi të synuar: Kush merr pjesë në kurset e mia dhe pse? (atributet, pritshmëritë, qëndrimet e grupit të synuar)
- Planifikimi i sekuencave të arsimit në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë

Organizimi

- Shqyrtim i kushteve kornizë
 - Veçantitë e grupit të synuar përkatës
 - Pritshmëritë e klientit
 - Infrastruktura e disponueshme (koha, vendi, materialet)
- Krijimi i listës së kontrollit për kursin
- Krijimi i një plani për orën mësimore (me detajet e metodave, didaktikën, afatin)
- Përdorimi i burimeve (materiale planifikimi dhe përdorim pajisjesh)
- Planifikimi i skenarëve të mundshëm/alternativë në rast të situatave të papritura
- Përgatitja personale e arsimuesit të të rriturve (kognitive, mendore, emocionale, niveli fizik)
- Shkrimi i teksteve të njoftimit /përshkrimeve të programeve të edukimit për pjesëmarrësit dhe/ose klientët
- Vijimsia e programit arsimor

Vlerësimi

- Koncepti i cilësisë në arsimin e vazhdueshëm - rëndësia, sqarimi i termave
- Elementet e sigurimit të cilësisë (cilësia në lidhje me: ambientet, programet, personelin), kriteret dhe treguesit
- Vlerësimi si bazë për sigurimin e cilësisë - parimet, parakushtet dhe potenciali
- Vlerësimi në kontekstin e vlerësimit
- Llojet e vlerësimit
 - preformativ, formativ (shoqërues) dhe përmbledhës (ex post)
 - sasior dhe cilësor
 - i jashtëm, i brendshëm, vetëvlerësimi
 - Vlerësimi i orës mësimore
- Fazat e vlerësimit
- Metodat e vlerësimit, teknikat dhe mjetet
 - Testi, pyetësi, shkallëzimet, dosjet
 - Ditarët e të nxënësve
 - Fletët e bilancit dhe protofoliot e kompetencës
- Raportet
- Përdorimi i rezultateve të vlerësimit për ta drejtuar procesin e arsimit
- Vijimsia dhe rjetimi

Sigurimi i cilësisë

- Cilësia në kuptimin e të dhënave, procesimit të lëndës dhe rezultateve
- Shtresat e cilësisë: Sistemi, organizimi, kursi, etj.
- Standardet/Treguesit
- Sistemet ekzistuese të sigurimit të cilësisë

Literatura e sugjeruar (përzgjedhje)

- Archer, David; Cottingham, Sara: *Reflect Mother Manual*, London, o.J.
<http://www.reflect-action.org/sites/default/files/u5/Reflect%20Mother%20Manual%20-%202012.pdf>
- Bramley, Peter: *Evaluating Training*, London 2003
- Caffarella, Rosemary S.: *Planning programs for adult learners. A practical guide for educators, trainers, and staff developers*. 1. ed. San Francisco 1994

Shënime mbi zbatimin

Ky modul përqendrohet në blerjen e mjeteve të nevojshme për instruktorët e kursit. Prandaj, një rol i rëndësishëm është të jepen mjete të përshtatshme për vlerësimin e nevojave, planifikimin, organizimin dhe vlerësimin e orëve të mësimet që plotësojnë kërkesat e didaktikës të përshtatshme për të rriturit. Përvojat e pjesëmarrësve nga praktika e tyre duhet të përdoren si pjesë e këtij procesi. Arsimi i të rriturve duhet të reflektojë në mënyrë kritike implikimet e përzgjedhjes dhe të zbatimit të mjeteve individuale në dritën e parimeve teorike të paraqitura në modulet e tjera. Ky modul thërret për një përzierje metodash të përbëra nga inpute tematike, këmbime profesionale dhe diskutime në grup. Në fund të këtij moduli pjesëmarrësit do të kenë fituar përvojë fillestare për aplikimin e metodave të përzgjedhura në praktikë, të cilat do të sigurojnë efekte të qëndrueshme të të nxënësve. Veç kësaj, ata duhet t'i marrin kompetencat themelore për të planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar procesin e tyre të të nxënësve në të ardhmen.

Zbatimi praktik dhe reflektimi

Metoda të ndryshme mund të përdoren për të mbështetur pjesëmarrësit që të mësojnë mënyrën më të mirë për ta krijuar ciklin prej 5 fazash. P.sh. pjesëmarrësit do të mund të ndahen në grupe, të marrin një temë dhe një detyrë për ta zhvilluar të gjithë ciklin, duke përshkruar hapat një nga një. Ata mund të përgatisin skenarë dhe të kenë një lloj përgatitjeje reale për mbajtjen e kursit. Bashkë, grupi mund të reflektojë mbi propozimet e ndryshme, të analizojë një zgjidhje të vetme, propozimet, idetë dhe ta rimendojë planin e përgatitjes para zbatimit të tij. Po ashtu, disa pjesë të procesit të implementimit mund të simulohen, ashtu që vlerësimi të bazohet në një lloj të rezultateve reale përmes diskutimit në grup. Çështjet e cilësisë duhet të lidhen me kontekstin e praktikës së tyre të vërtetë të arsimit.

Fushëveprimi i rekomanduar

- 32 orë udhëzime (≈4 ditë)
- 32 orë studimi dhe vlerësimi individual

Zbatim praktik dhe ushtrime

- e ndryshueshme (ndërmjet 25 dhe 120 orë) sipas nevojës

Modul(e) zgjedhor(e): tema të ndryshme

Kompetenca

Individët që kanë përfunduar Kurrikulën globALE kanë fituar në thellësi njohuri të specializuara, faktike dhe teorike lidhur me të paktën një fushë të veçantë ose një aspekt të veçantë të veprimtarisë profesionale të një arsimuesi të të rriturve. Ata kanë fituar një gamë të plotë aftësish njohëse e praktike të nevojshme për punën profesionale në këtë fushë, ose për t'u marrë me këtë aspekt, përkatësisht.

Lidhjet me modulet e tjera

Modul(et) zgjedhor(e) janë mundësi që pjesëmarrësit

- të thellojnë më tej njohuritë dhe aftësitë e fituara në modulet kryesore lidhur me një temë të veçantë (p.sh. vlerësimin, zhvillimin e kurrikulave, diversifikimin e metodave sipas llojeve të ndryshme të nxënësve, etj.)
- të zhvillojnë dhe zbatojnë më tej njohuritë dhe aftësitë e fituara në modulet bazë për një kontekst të veçantë (p.sh. mësimdhënie dhe nxënie në programet e shkrim-leximit për të rritur)
- të zgjerojnë profilin e tyre të kompetencave duke përvetësuar njohuri dhe aftësi lidhur me një fushë ose aspekt që lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale, por që nuk është pjesë themelore e moduleve kryesore (p.sh. menaxhimi në arsimimin e të rriturve, lobimi në arsimimin e të rriturve)

Temat

Mund të përdoren të gjitha llojet e temave që janë të rëndësishme për një aktivitet të arsimuesit profesional të të rriturve në një kontekst të dhënë

Shënime mbi zbatimin

Formati dhe qasja didaktike do të varen shumë nga tema e zgjedhur dhe prandaj nuk mund të jepen indikacione të përgjithshme. Sidoqoftë, parimet e përgjithshme themelore të Kurrikulës globALE, të tilla si orientimi i pjesëmarrësve dhe orientimi nga veprimi duhet të respektohen në hartimin e modulit zgjedhor.

Fushëveprimi i rekomanduar

Modul(et) zgjedhor(e) janë pjesë përbërëse e Kurrikulës globALE dhe prandaj nuk duhen heqë në kuadrin e një programi të plotë të trajnimit KG. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për certifikimin. Si me modulet bazë, RPL sigurisht mund të zbatohet për qëllime të certifikimit.

Në rastin e një moduli të mësuar (ose disa moduleve të mësuara) fushëveprimi i përgjithshëm i rekomanduar do të jetë:

- 64 orë udhëzime (≈8 ditë)
- 56 orë studimi dhe vlerësimi individual

Zbatim praktik dhe ushtrime: 50 orë

Rreth DIE dhe DVV International

Instituti gjerman për arsimin e të rriturve - Qendra Leibniz për Mësim Tërëjetësor (**DIE**) financohet nga qeveria federale dhe shtetet federale. Ajo bën kërkime në fushën e mësimdhënies dhe të nxënies të të rriturve, programe të vijueshme të arsimit dhe institucione, si në kontekstet politike dhe institucionale të mësimin tërëjetësor.

Hulumtimi dhe zhvillimi në DIE mbulon disa çështje kolosale të rëndësishme shoqërore, p.sh.: Si mundën sistemet e arsimit të vazhdueshëm ta shtojnë pjesëmarrjen dhe kompetencat dhe t'i reduktojnë pabarazitë sociale? Si mund të organizohen institucionet e arsimit të vazhdueshëm dhe të menaxhohen për të qenë pedagogjikisht efikase? Si mund të përshtaten programet e arsimit të vazhdueshëm për të përmbushur nevojat dhe kërkesat? Si funksionon mësimdhënia, nxënia dhe puna këshilluese në arsimin për të rritur dhe atë të vazhdueshëm? Si mundën shërbimet tona shkencore të mbështesin dhe të lehtësojnë aktivitetet kërkimore?

DIE

- kryen hulumtim relevante për aplikim dhe hulumtim themelor,
- ofron transferim të njohurive dhe infrastruktura për kërkime,
- zhvillon koncepte inovative për praktikuesit,
- dhe këshillon aktorët e politikës kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të vazhdueshëm.

Hulumtimi i institutit dhe shërbimet e tij kërkimore përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm të shkencës së arsimit të vazhdueshëm, si dhe të praktikës dhe politikës në fushën e arsimit për të rritur. Shërbimet e DIE zhvillohen në dy departamente: Qendra për Kërkime dhe Zhvillim (FEZ) dhe të Qendra për të Dhëna dhe Informacion (DIZ). FEZ ofron hulumtime themelore dhe zhvillim të orientuar drejt aplikimit. DIZ mundëson kërkime, duke siguruar infrastrukturën dhe transferimin e njohurive me botime, baza të të dhënave dhe marrëdhëniet të përgjithshme publike.

DIE vendos kontakte mes aktorëve në edukimin e vazhdueshëm kombëtar dhe ndërkombëtar, e prandaj është kështu kontakti qendror, ndërdisiplinor e aktiv në këtë fushë. Kjo është detyrë thelbësore e bazuar në natyrën shumëfishtë të fushës së arsimit të vazhdueshëm gjerman (dhe më shumë, ndërkombëtar).

DVV International është Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Deutscher Volkshochschul-Verband e.V. (Shoqata Gjermane për Arsimin e të Rriturve). DVV përfaqëson interesat e rreth 920 Qendrave të Arsimit të të Rriturve (Volkshochschulen) dhe shoqatave të tyre shtetërore, ofruesve më të mëdhenj të arsimit të mëtejshëm në Gjermani.

Si organizatë udhëheqëse profesionale në fushën e arsimit për të rritur dhe të bashkëpunimit për zhvillim, DVV International është zotuar ta përkrahë mësimin tërëjetësor për mbi 45 vjet. DVV International siguron përkrahje në gjithë botën për ngritjen dhe zhvillimin e strukturave të qëndrueshme për arsimin e të rinjve dhe të rriturve.

DVV është një partner profesional në dialog me njerëzit lokalë. Për ta arritur këtë, bashkëpunon me më se 200 partnerë të shoqërisë civile, të qeverisë dhe akademikë në më se 30 vende në Afrikë, Azi, Amerikën Latine dhe Evropë. Zyrat në vende dhe ato rajonale të DVV-së ndërtojnë bashkëpunim lokal e rajonal dhe sigurojnë cilësinë dhe efektivitetin e veprimit në vendet partnere. Puna e tyre fokusohet në arsim të shkrim-leximit dhe themelor, formimin profesional, të mësuarit global dhe ndërkulturor, edukimin mjedisor dhe zhvillimin e qëndrueshëm, migrimin dhe integrimin, punën me refugjatë, edukimin shëndetësor, parandalimin e konflikteve dhe edukimin e demokracisë.

DVV International financon punën e vet me fonde nga donatorët institucionalë dhe privatë. Në bashkëpunim me shoqatat kombëtare, rajonale dhe globale të arsimit të të rriturve, DVV International promovon punën lobuese dhe avokuese për të drejtat e njeriut për arsimin e mësim tërëjetësor. Për të arritur këtë, orientohet me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të OKB-së (OZHM), programin Arsimi global për gjithë (EFA) dhe Konferencën Botërore të UNESCO-s për Arsimin e të Rriturve (CONFINTEA). DVV International përkrah shkëmbimin evropian dhe global të informacionit dhe të ekspertizës përmes konferencave, seminareve dhe publikimeve.

**Institute for International
Cooperation of the German
Adult Education Association**

DVV International

Obere Wilhelmstraße 32
53225 Bonn
Germany

Tel.: +49 (0) 228 97569-0
Fax: +49 (0) 228 97569-55

info@dvv-international.de
www.dvv-international.de

**German Institute for
Adult Education**

**Leibniz Centre for
Lifelong Learning (DIE)**

Heinemannstraße 12–14
53175 Bonn
Germany

Tel.: +49 (0) 228 3294-0
Fax: +49 (0) 228 3294-399

info@die-bonn.de
www.die-bonn.de

Further Information:
www.curriculum-globale.de



Sponsored by